

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR VENDOSJEN E SEPERACONIT PËR SEPERIMIN E SHKËMBIT
GËLQËROR TË MËRMERIZUAR NË RAHOVEC**



„RUBINI CORP” SH.P.K.

Aplikuesi:

Hartuesi i raportit:

„Rubini Corp” Sh.p.k.

Dr.sc. Astrit Shala

Prishtinë Korrik, 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR VENDOSJEN E SEPERACONIT PËR SEPERIMIN E SHKËMBIT
GËLQËROR TË MËRMERIZUAR
KOMUNA E RAHOVECIT NË NGASTRËN
KADASTRALE NR: P- 71510057-02256-0**

Investitori: „RUBINI CORP” SH.P.K.

Aplikuesi:

Alben Pllava

„Rubini Corp” Sh.p.k.

Adresa: Fushë Kosovë dhe Fshati

Zatriq Rahovec

Zona Industriale, 21000, Rahovec

E-mail: albenpllava@gmail.com

Mobile: +383 289 840

Hartuesi i raportit:

Dr. sc. Astrit Shala

Email: astrit-shala@hotmail.com

Tel: 044800098

Adresa: Prishtinë

Hartuesit;

1. Dr. sc. Astrit Shala,

Contents

1. HYRJE.....	5
2. VENDNDODHJA E PROJEKTIT	6
3. PËRSHKRIMI I VEÇORIVE FIZIKE TË PROJEKTIT	11
3.1. Përshkrimi procesit teknologjik te seperimit dhe seperacioni	14
4. SISTEMI I MBIQYRJES DHE KONTROLLIT	17
5. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	19
6. GJENDJA AKTUALE NE MJEDIS.....	20
7. KARAKTERISTIKAT FIZIKO-GJEOGRAFIKE	30
7.1. Ndërtimi Gjeologjik	30
7.2. Tektonika.....	31
7.3. Karakteristikat Pedologjike	32
7.4. Karakteristikat Hidrografike	35
7.5. Karakteristikat Seizmike	37
7.6. Karakteristikat Klimatike.....	38
7.7. Erërat.....	39
7.8. Flora dhe Fauna.....	39
7.9. Peizazhi.....	41
8. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	43
8.1.Ndikimet në ajër.....	44
8.2. Ndikimet në ujë.....	44
8.3. Ndikimet në tokë.....	45
8.4. Ndikimet e zhurmës ne mjedis	46
8.5. Ndikimet në florë dhe faunë	46
8.6. Ndikimet në mikroklimë.....	46
8.7. Ndikimet në peizazh	47
8.8. Ndikimet në mjedis pas fazës të mbylljes se seperacionit.....	48
8.9. Trashëgimia Kulturore	48
8.10. Ndikimet në popullata dhe vendbanimet	49
9. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS.....	50
10. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLE RSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	51
11. PERSHKRIMI I MASAVE.....	53
11.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	54

11.2. Masat për mbrojtjen e ujit	55
11.3. Masat për mbrojtjen e tokës.....	57
11.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma.....	58
11.5. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	59
11.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	59
11.7. Rastet aksidentale.....	59
11.8. Siguria përfshijnë punët përgatitore.....	60
11.9. Menaxhimi i mbeturinave.....	61
12. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	62
13. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	62
14. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT.....	62
14.1. Objektivat e rikultivimit.....	62
14.2. Qëllimi i Rikultivimit.....	63
15. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	65
16. LITERATURA E PERDORUR	66

Lista e Figurave;

Figura 1. Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës.....	6
Figura 2.Harta topografike e zonës ku do te vendoset seperacioni/ gurëthyesi.....	7
Figura 3. Ortofoto me kufijtë e zonës dhe koordinatat.....	8
Figura 4. Ortofoto lokacionit dhe rrugëve.....	9
Figura 5. Distanca me minierat tjera.....	10
Figura 6. Distanca me vendbanimet.....	10
Figura 7. Foto te seperacionit/ gurëthyesit mobil.....	11
Figura 8. Sistemi i kontrollit automatik te procesit teknologjik	16
Figura 9. Harta e degradimit te lumenjve, tokave dhe mbeturinat.....	21
Figura 10. Ortofotot degradimi i tokave dhe lumenjve ne komune e Rahovecit.....	23
Figura 11. Harta e erozionit ne komunën e rahovecit.....	25
Figura 12. Harta e trashëgimia kulturore dhe natyrore.....	29
Figura 13. Gjeologjia e komunës	31
Figura 14.Boniteti i tokave	35
Figura 15. Harta Seizmika e komunës Rahovecit	38
Figura 16. Shpejtësia mesatare e erës në m/sek në Rahovec.	39
Figura 17. Harta e pyjeve, kullosat dhe livadhet në komunën e Rahovecit	41
Figura 18. Pamje e lokacionit ku do te vendoset seperacioni.	42
Figura 19. Foto lokacioni te seperacionit.	49
Figura 20. Skema teknologjike e ujerave.....	56
Figura 21. Shema e distancës se mbjelljes.....	64

1. HYRJE

Kompania „Rubini Corp” Sh.p.k. e cila gjendet në Fushë Kosovë, ka iniciuar procedurat për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për sipërmin e shkëmbit gëlqeror që planifikon të vendose seperacionin/gurthyesin në fshatin Zatriq komuna Rahovec. **Ndërsa, zona ku planifikohet të vendoset seperacioni është zone aktive minerare, ku kompania është pajisur me licencë të KPMM-s dhe se fundi është pajisur me Leje Mjedisore nga MMPHI.**

Për arsyeje që të respektohen të gjitha normat ligjore kompania ka iniciuar procedurat për hartimin e Raportin të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis/VNM.

Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, për shfrytëzim të gurit gëlqeror të mërmëtizuar. Komuna e Rahovecit në ngastrat kadastrale nr: P- 71510057 – 02256-0 e cila parcelë i ka 5698780 m².

Me këtë synohet që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarinë e shfrytëzim të gurit gëlqeror të mërmëtizuar duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari.

Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku do të zhvillohet ky aktivitet, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e këtij raporti të VNM-së, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin impiantit e sipërmit, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në rrethin dhe regjionin më të gjerë.

Nisur nga qëllimi paraprak dhe nga metodologjia e hartimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikim i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit të impiantit, gjatë realizimit të procesit teknologjik të prodhimit të seperimit të shkëmbit gëlqeror, dhe pas përfundimit të aktiviteti.

Pra me këtë raport do të ofrohen informata të mjaftueshme për zonën ku shtrihet projekti, zonën me të gjerë dhe ndikimet e këtij aktiviteti në mjedis, si dhe masat mjedisore që ndërmerren gjatë ngritjes këtyre kapaciteteve, gjatë operimit dhe pas përfundimit të aktivitetit prodhues.

Për hartimin e këtij raporti janë siguruar të dhëna nga burime të ndryshme, literatura ekzistuese, web faqja e komunës në fjalë, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktivitetëve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar disa vizita në vendin ku bëhet investimi, me qëllim të njohjes me zonën, me të dhënat për pajisjet që janë dhëna nga vete investitori, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.

2. VENDNDODHJA E PROJEKTIT

Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.89 km², që shtrihet në regionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në V-L me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në J-L me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km.. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi. Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshorë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshina janë këto: (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Baboc, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe. Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoc.

Ndërsa Lokacioni i seperacionit që planifikohet të vendoset kompania Rubini është brenda kufirit Komunës së Rahovecit në afërsi të fshatit Zatriq, ku me komunën e Rahovecit e ka në vij ajrore një distance mbi 6.5 km. Koordinata e zonës në fjalë janë: 42,52069°N, 20,64975° E.





Figura 1. Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës.

Lokacioni gjendet ne kufi mes Malishevës dhe Rahovecit, lartësitë mbidetare prej 800m, nga me fshati Zatriq ka një distance mbi 2.9km, me fshatin Gurbardhi ka një distance mbi 2.5 km dhe me fshatin Astrazup një distance mbi 3.8 km.



Sepaeracioni qe planifikohet te vendoset ne afërsi te fshatit Zatriq te komuna se Rahovecit ku ngastrat kadastrave është ne nr: P- 71510057-02256-0, e cila parcelë i ka 5698780 m².

Koordinata e sipërfaqes ku do te ngritët seperacioni, e gjithë zona ka një sipërfaqe prej: S=7 hektar, janë paraqitur me poshtë.

Ne imazhet (figurat, 4, 5 dhe 6), me poshtë është paraqitur lokacioni ku do te vendoset seperacioni dhe distanca ne mese te rrugëve, minierave tjera dhe vendbanimeve.



Figura 4. Ortofoto lokacionit dhe rrugëve.

Ne foto me poshtë shihen një numër i konsiderueshëm i minierave te shfrytëzimit dhe sipërmit te shkëmbit gëlqeror, ku disa nga këto miniera aplikojnë metodën me prerje te shfrytëzimit te shkëmbit gëlqerore për aplikime dekorative.




Figura 5. Distanca me minierat tjera.




Figura 6. Distanca me vendbanimet.

3. PËRSHKRIMI I VEÇORIVE FIZIKE TË PROJEKTIT

Kompania fillimisht do të vendos një speracion/gurëthyes mobil i cili do të ketë një kapacitet të seperimit $Q=300\text{m}^3/\text{h}$.




Figura 7. Foto te seperacionit/gurëthyesit mobil.

Ndërsa, me vone do te vendos një seperacion statik ku kapaciteti i prodhimit do te jete $Q=450\text{m}^3/\text{h}$.

Zgjedhja e Seperacionet me të gjitha pajimet përcjellës, që do të përshkruhet është e tipët Gjerman i prodhimit i viteve te fundit dhe me një kapacitet $Q=450\text{m}^3/\text{h}$.

Ky impiant i sipërmit te shkëmbit gëlqerore në procesin teknologjik të sipërmit në fjalë përfshin fazat e mëposhtme:

- faza e parë – hedhja e shkëmbit ne rezervarin
- faza e dytë – thyerja e tije apo bluarja ne mullirin kryesore
- faza e tretë – ndarja ne fraksione dhe bluarja si pas tabelës poshtë

Fraksioni	Granulim mm.	$\text{m}^3\%$
I	0-4	30-35
II	4-8	25-30
III	8-16	23-25
IV	16-32	17-20

- faza e katërt – bartja përmes shiritave transportues

Zbrazja e gurit gëlqeror në hinkën pranuese -Mbushja e hinkës bëhet nëpërmes kamionëve që sjellin gurin gëlqeror nga vend eksploatimi-shfrytëzimi dhe zbrazjes se tyre në hinkë-bunkerit pranues përmes kiperit te kamionit.

Kapaciteti i thërrmimit: $Q=450\text{m}^3/\text{h}$.

Dimensionet	15500 mm
Gjërësia	3000mm
Lartësia	4000mm
Pesha	48500 kg

Sitat	
Gjatësia	8000mm
Gjërësia	3000mm
Lartësia	4000mm
Kapaciteti	O=450m ³ /h.450m ³

Shiriti transportues 1	
Gjatësia	15000mm
Gjërësia	800mm
Këndi	0-22°
Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

Shiriti transportues 2	
Gjatësia	12000mm
Gjërësia	1800mm
Numri i rrotullimeve	1450 /min
Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

Shiriti transportues 3	
Gjatësia	10000mm
Gjërësia	600mm
Këndi	0-22°

Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

Shiriti transportues 4	
Gjatësia	10000mm
Gjërësia	600mm
Këndi	0-22 ⁰
Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

Shiriti transportues 5	
Gjatësia	12000mm
Gjërësia	600mm
Këndi	0-22 ⁰
Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

Shiriti transportues 6	
Gjatësia	8000mm
Gjërësia	1000mm
Këndi	0-22 ⁰
Distanca në mes ruleve në krahun ngarkues	L=800
Distanca në mes ruleve në krahun Bosh	L=1500

3.1. Përshkrimi procesit teknologjik të seperimit dhe seperacionit

Procesi i thërrmimit-bluarjes dhe seperimit-ndarjes së fraksioneve të gurit gëlqeror nga kompania, është proces i cili do të përfshijë thërrmimin-bluarjen e masës gurore në mulli dhe me pastaj përmes seperacionit, ku do të bëhet ndarja e fraksioneve të ndryshme përmes sitave të caktuara sipas fraksioneve të dëshiruara, kërkuara nga tregu. Kompania e ka dhe vend shfrytëzimin e gurit gëlqeror por që i njëjti është me një vend sipërmi dhe si i tilla do të trajtohet veçanta (*kompania ka pëlqim mjedisore për vend shfrytëzimin e gurit gëlqeror*). Prandaj në vijim do të trajtohet vetëm thërrmimi dhe sipërmi i gurit gëlqeror.

Zbrazja e gurit gëlqeror në hinkën pranuese - Mbushja e hinkës bëhet në përmes kamionëve që sjellin shkëmbi gëlqeror nga vend eksploatimi-shfrytëzimi dhe zbrazjes së tyre në hinkë përmes kiperit të kamionit.

Spërkatja-lagia e gurit gëlqeror gjatë bluarjes - Lagia e materialit-lëndës së parë bëhet me vrushkullin e ujit, i cili rrjedh nëpër gypat të vendosur mbi sitat e sepëracionit. Qëllimi i spërkatjes është në minimizimi e pluhurit nga procesi i tharmimit dhe sepërimit të gurit gëlqeror.


Ndarja-sepërimi i fraksioneve të zhavorrit - Ndarja e granulateve-fraksioneve të zhavorrit pas procesit të thyerjes-bluarjes së tij realizohet me sita të cilat janë të vendosura në shtresa dhe kanë rrjetat me dimensione përkatëse. Secila sitë në fund ka hinkën përkatëse e cila shkarkon granulat në transporterin përkatës.

Granulatet ndahen sipas kësaj renditje:

- Granulacioni i parë me i madh 0-4 mm -sita e parë,
- Granulacioni i dyti me i madh 4-8 mm - sita e dytë,
- Granulacioni i tretë me i madh 8-16 mm - sita e tretë,
- Granulacioni i katërt me i madh 16-22 mm-sita e katërt,

Ngarkimi i fraksioneve të sepëruara në kamiona transportues - Pas procesit teknologjik të bartjes, tharmimit dhe sepërimit-fraksionimit të zhavorrit, ngarkimi i tij bëhet me lugë ngarkuese nëpër kamionë, ku dhe bëhet transportimi në destinacionet e caktuara, pra transportohet për treg deri te parashtruesi i kerkese për furnizim me zhavorr për nevojat e veta.

Skema e procesit teknologjik






Figura 8. Sistemi i kontrollit automatik te procesit teknologjik

4. SISTEMI I MBIKQYRJES DHE KONTROLLIT

Procesi teknologjik i Impianti te seperacioni në tërësi do të menaxhohen përmes një sistemi automatizuar dhe nga stafi i kompanisë.

Në përgjithësinë e tij, sistemi do të kontrollojë drejtpërdrejt pajisjet dhe sistemet e mëposhtme:

- pajisjet për thërrmimin e materialit;
- pajisjet e transportit të materialit për mes shiritave;
- transportit të mbushjes;
- pajisjet për deponimin e masës së gatshme;
- Si dhe pajisjet tjera përcjellëse që si tersi janë pjesë e procesit teknologjik.

Përveç monitorimit të automatizuar do të jetë stafi i angazhuar me trajnimet dhe kualifikimet e duhura që ta bëjë monitorimin në vazhdimësi të avarive të mundshme, përcjelljen e parametrave në ekranet e pajisjeve brenda normave normale.

Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë operimit

Uji – Në kushte normale, ky aktivitet subjekt i këtij vlerësimi të ndikimit në mjedis, nuk parasheh përdorimin e ujit për nevoja industriale, (mire po uji do të përdoret për të parandaluar pluhurin gjatë thërrmimit) dhe rrjedhimisht nuk parasheh shkarkimin në ujëra. Ndikimet në ujëra, mund të rezultojnë nga:

- Derivatet, vajrat dhe lubrikantet të ndryshme të cilat mund të derdhen nga makineritë në përdorim
- Pastrimi i ambientit në rast të ndonjë rrjedhjeje të padëshiruar
- Në rastet e pastrimit të automjeteve të transportit në zonën e projektit
- Në raste të ndonjë avari të makinerive transportuese

Gjatë fazës së montimit dhe operimit të seperacionit ujë do të përdoret për disa arsyeje të ndryshme, të cilat ujëra mund të kenë edhe ndikime në mjedisore.

- Ujërat e lagës së sheshit të qarkullimit të automjeteve;
- Ujërat e përdorur për ambientet hijeno-sanitare të ambientit të stafit;
- Ujërat që përdoren për parandalimin e ngritjes së pluhurit gjatë procesit të tharmimit;
- Ujërat e pastrimit të ambientit të punës. Veçmas, në rast të operimeve të pakontrolluara, mund të ketë efekte negative në rrjedhën ujore në afërsi në këtë rast nuk kemi.

Ajri - Ndikimet në ajër, mund të rezultojnë gjatë disa fazave të operimit dhe ndërtimit, sidomos në rast të mos kujdesit dhe mos ndërmarrjes së masave paraprake për parandalimin e emisioneve. Emisionet mund të shkarkohen në disa faza:

Seperacioni – Kjo është faza që më së shumti mund të rezultojë me emisione të pluhurit, për shkak se makineritë do të jenë vazhdimisht aktive. Në këtë pjesë teknologjike, pluhuri mund të emitohet në disa hallka: a) bluarja, b) transferim me shirit transportues, c) fraksionizmi, c) ngarkimi i materialit final të fraksionuar në kamion transportues. Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Emisione nga motorët me djegie të brendshme. Ndikime në ajër do të rezultojnë edhe nga gjeneratorët për prodhim të energjisë elektrike për funksionim të seperacioni, si dhe nga makinat operuese, si eskalator, buldozer, kamion.

Gjatë gjithë këtyre fazave të procesit teknologjik, nga ku lirohen grimca të pluhurit, këto grimca emetohen në ajër, dhe pastaj për shkak të peshës së tyre gravitojnë në tokë, në afërsi të impiantit, ose varësisht prej erës mund të transferohen në mjedisin përreth. Në kushte të mos ndërmarrjes së masave zvogëluese, si rezultat i reliefit dhe kushteve tjera mjedisore, këto grimca mund të barten edhe në distanca më të largëta. Nivel më pak relevant i ndotjes së ajrit mund të vije edhe nga emisionet e gazrave të automjeteve që përdoren, si lugë ngarkuese kamion etj. Marrë në tërësi, gurëthyesi N t janë ndotës të mëdhenj të ajrit me thërmia të ngurta. Shikuar nga aspekti i përbërjes granulometrike pluhuri i liruar nga separacioni i takon fraksioneve të imta të rërës e cila në gjendje të thatë bartet dhe përmes erës lëvizë në hapësira më të mëdha. Pluhuri lirohet, pothuajse në të gjitha fazat e procesit të përshkruara më lartë, prandaj edhe konsiderohet ndikimi kryesor i këtij aktiviteti.

Dheu – Gjate fazës së operimit dhe montimit –ndikime negative në tokë mund të paraqiten nga: gërmimi në zonë paraqesin ndikimin kryesor në tokë. Kjo rezulton me ndërhyrje fizike në strukturën origjinale të tokës. Megjithatë ky është aktivitet i planifikuar dhe i kontrolluar.

Masat e rehabilitimit të zonës pas mbylljes së projektit do ta kompensojnë efektin e realizuar.

Ndikimi më i madh në cilësinë e tokës do të vije në rast të përdorimit të makinerive të vjetruara, për shkak të rrjedhjes së vajrave apo karburanteve. Si dhe në rast të papërgjegjësive të stafit, gjatë shtimit të karburantit apo vajrave në makineritë në zonë, apo gjatë proceseve servisuere.

Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme; si dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga stafi / punëtorët.

Depozitimi i pluhurave të rezultuara si dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta që mund të përdoren në zonë

Po ashtu do të ketë ndikime edhe nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor.

Zhurma Zhurma është një nga ndikimet e rëndësishme që duhet trajtuar. Zhurma do të krijohet si rezultat i pothuajse të gjitha hallkave të procesit, duke filluar nga separacioni, si dhe përdorimi i makinerive. Megjithatë, zhurma do të ketë një karakter lokal dhe nuk do të ketë ndikim në zonat e banuara dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë biznes nuk pritet që të tejkalojnë nivelin e lejuar të zhurmës. Zhurma dhe verbimet që krijohen gjatë punës nuk pritet të ndikojnë në popullatën lokale. Po ashtu gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka aktivitete që zhvillohen gjatë natës që mund të ndikojnë në krijimin e zhurmave.

5. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e impiantit me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt qe është planifikuar te ndertohet është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për seperim janë si me poshtë:

- [LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025](#)
- [LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA](#)
- [LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147](#)
- [LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174](#)
- [LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA](#)
- [LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE](#)
- [LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES](#)
- [LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA](#)
- [LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM](#)
- [LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË](#)
- [LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM](#)
- [LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA](#)
- [LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES](#)
- [LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE](#)
- [LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI](#)
- [LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE](#)
- [UHËZIM ADMINISTRATIV \(MMPHI\) NR. 02/2022 PËR KUSHTET, MËNYRAT, PARAMETRAT DHE VLERAT KUFIZUESE TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË RRJETIN E KANALIZIMIT PUBLIK DHE NË TRUPIN UJOR](#)
- [LIGJI Nr. 04/L-158 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-163 PËR MINIERAT DHE MINERALET](#)

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

6. GJENDJA AKTUALE NE MJEDIS

Ndotja e mjedisit është një problem mjaftë serioz dhe është prezent pothuaj se kudo ne vendet qe ka pasur zhvillim te industrisë. Ky problem është edhe në Kosovës, po o ashtu edhe në komunën e Rahovecit.

Ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj. Gjithashtu hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në veri te Rahovecit ne kufi me Malishevën, ne bjeshkët e Zatriqit behën disa eksploatime te shkëmbinjve gëlqerore te cilët ndikojnë me emetimin e grimcave pezull ne atmosfera dhe ne mjedisin e komunës, kjo zone pritet te marre statutin e zonës industriale. Ndërsa shqetësues për komunën e Rahovecit janë guroret te hapura ne pjesën lindore dhe veri-lindore te komunës, pasi qe kane nja afërsi me vendbanimin kryesore te qytetit.

Ndotja e ajrit - Rahoveci me pozitën e përshtatshme gjeografike që ka, larg shkaktarëve kryesor të ndotjes në nivel të Kosovës, mund të konsiderohet ndër komunat me cilësinë më të mirë të ajrit. Nuk ka stabilimente të industrisë së rëndë që do të mund të konsideroheshin si burim kryesor i ndotjes së ajrit. Edhe ato ndërmarrje publike, prodhuese apo shërbyese, që kanë funksionuar në sistemin e kaluar, sot ose nuk ekzistojnë fare ose funksionojnë me kapacitet të reduktuar, dhe nuk paraqesin burime të përfillshme të ndotjes. Bazuar në këto që u than më lartë mund të konkludojmë se burimet potenciale të ndotjes së ajrit në komunë, e veçanërisht në zonat urbane dhe vendbanimet me dendësi më të madhe të ndërtimit, janë:

- Trafiku dhe transporti
- Ndezjet për përfitim të energjisë për ngrohje
- Gjeneratorët për prodhim të energjisë
- Aktivitetet e ndërtimit
- Guroret e hapura për eksploatim te cilat ndodhen kryesisht ne fshatin Zatriq dhe ne Hoçë te Madhe

Komuna nuk disponon me mjete për matjen e sasisë së ndotjes, prandaj si nevojë e ngutshme shtrohet nevoja për pajisje me qellim të matjes së ndotjes që shkaktojnë operatorët industrial gurëthyesit si dhe qarkullimi i automjeteve në zonën urbane dhe përgjatë magjistrales Pejë-Rahovec-Prizren.

Trafiku dhe transporti - Sistemi aktual i transportit në Kosovë konsiderohet ndër shkaktarët e problemeve të ndotjes për shkak të rritjes së madhe dhe mungesës së formave tjera të transportit të mallërave, respektivisht, mosfunksionimit të transportit të mirëfilltë hekurudhor. Problem tjetër paraqet vjetërsia e mjeteve të transportit të mallërave dhe automjeteve tjera, dhe moszbatimi i përpiktë i ligjit për kontrollimin e gjendjes teknike të tyre. Ne komunën e Rahovecit ndotja nga transporti nuk ndihet shume e sidomos pas hapjes se autostrades Ibrahim Rugova.

Ndotja e ujit – Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edh ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Në bazë të klasifikimit të cilësisë së ujërave në komunën e Rahovecit janë prezentë tri shkallë të ndotjes. Në shkallën e parë që, nuk ka ndotje kimike dhe biologjike, janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime. Shkallës IIa të ndotjes i takojnë të gjithë lumenjtë dhe prroskat e komunës së Rahovecit dhe shkallës IIb i takon Drini i Bardhë. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor

shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza. Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është 90439 banorë (sipas të dhënave të Komunës për vitin 2010) atëherë 90439 X 16.46=148626m³/vit ujëra të zeza ose 46 litër/sek pa llogaritur objektet industriale.




Figura 9. Harta e degradimit të lumenjve, tokave dhe mbeturinat

Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedis të pastra. Lumenjtë janë

pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka.

Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike, ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratit të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave. Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

Degradimi i lumenjve - Në bazë të dhënave komunale nxjerrja e inerteve ka shkaktuar degradim të shtretërve të lumenjve dhe, si pasojë ka ardhur deri të ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotjen dhe shkatërrim e biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij. Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjve shkaktojnë edhe vërshime në tokat bujqësore. Operatorët legal dhe ilegal që veprojnë përgjatë shtratit të lumit Dri nga hyrja e lumit në zonat katastrale të Rahovecit në Mrasor e deri në dalje të saj në Krushë të Madhe, përveç në epigjeninë e kanjonit të Urës së Fshejtë, kanë degraduar sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore si dhe është shkatërruar shtrati i lumit me 403.9 ha si dhe mbeturina të ngurta me rreth 25 ha jo vetëm në shtretërit e lumenjve por edhe në zonat lumore. Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjene, kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit. Sipërfaqja ujore në komunën e Rahovecit, në bazë të vrojtimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, si dhe nga burimet e Agjencionit Katastral të Kosovës është: sipërfaqja ujore e lumenjve rreth 490 ha prroskave 2.5 ha dhe kanaleve ujore 2.2 ha. Këto sipërfaqe ujore kanë pësuar ndryshime për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjve, shkatërrimit inteziv nga nxjerrja e zhavorreve dhe për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët që kanë pronat përgjatë shtratit të lumit. Krijimi i fyteve shkakton edhe vërshime të tokave bujqësore. Mbeturinat janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës .

Ndotja e tokës dhe degradimi i tokës - Degradimet janë dukuri edhe në komunën e Rahovecit në forma të ndryshme: Nxjerrja e inerteve përgjatë shtratit të Lumit Drini i Bardhë, Gurthyesve si dhe hedhja e mbeturinave të amvisrisë si dhe ato të ngurta në pjesë të ndryshme të territorit të komunës. Degradimet me të ndjeshme në komunën e Rahovecit janë prezentë përgjatë shtratit të Lumit Drini i Bardhë. Operimet ilegale dhe legale në nxjerrjen e zhavorrit kanë shkaktuar dëme si në tokat bujqësore ashtu edhe ndotje të ujërave dhe në habitatin e shtratit të lumit. Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim, si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte ka pasoja të rënda mjedisore. Në bazë të vizitave në terren janë identifikuar këto dukuri në këto vendbanime: Kramovik, Qiflak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Xërxë dhe Krush e Madhe. Në këto zona kadastrale janë degraduar rreth 400 ha tokë buke. Dukuri e degradimit të mjedisit janë edhe gurthyesit që operojnë në veri të Rahovecit, përgjatë magjistrales Rahovec-Malishevë.



Figura 10. Ortofotot degradimi i tokave dhe lumenjve ne komune e Rahovecit.

Dukuri negative e dëmtimit dhe degradimit të pyjeve është edhe prerja ilegale e pyjeve, që si pasojë rritë sipërfaqet e zhveshura dhe inicion proceset negative të erozionit dhe vërshimeve. Përkujdesja e vogël ndaj pyjeve ka për pasojë edhe paraqitjen e sëmundjeve dhe insekteve, pastaj kalbja e drunjtëve në formacionet e bungut etj. Mjedisi jo i pastër dhe hedhja e mbeturinave të ngurta janë prezent në vendbanimet e komunës ku janë krijuar deponim ilegale që kanë pasoja për botën bimore dhe shtazore, si dhe në vetë mjedisin ku jeton njeriu. Gjatë hulumtimeve në terren janë vënë re pika degradimi edhe pranë shtretërve të lumenjve dhe në pjesë të ndryshme të tokave.

Ndotja nga zhurma - Trafiku dhe transporti rrugor, gjeneratorët, veprimtaritë e ndryshme të punës si aktivitetet e ndërtimit, gurëthyesit janë burime potenciale të zhurmës të cilët ndikojnë në uljen e kualitetit të jetës në vendbanime.

Erozioni Erozioni është njëri nga faktorët ekzogjen që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezente pothuajse në tërë territorin e komunës së Rahovecit, në forma dhe madhësi të ndryshme. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij në shumë raste e ka luajtur edhe faktori antropogjen si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër është prezentë mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit dhe paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore, lugjeve rrëkenore, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrojeve, etj. Procesi erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të Lumit Drini i Bardhë.

Tabela 1. Shkalla e erozionit

Kategoria erozive	sip-ha
Sipërfaqet pa erozion	822.8
Erozion shumë i dobët	6935
Erozion i dobët	8103
Erozion i mesëm	11093.2
Erozion shumë i fortë	596

Territori i komunës së Rahovecit karakterizohet me pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 6935 /ha, të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën Lindore dhe Jug-lindore, përkatësisht në lokalitetet Kramovik, Qiflak, Sarosh,, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xerxë, Bellacerk, Celinë, Nagavc, Krushë e Madhe. Keto sipërfaqe shtrihen në releiev të ultë përgjatë shtratit të lumit të Drinit të Bardhë dhe janë kryesisht toka aluviale deluviale dhe livadhore. Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe 8103 ha. Shtrihen në pjesën qendrore të komunës dhe përfshinë vendbanimet, Rahovec, një pjesë Brestovc, një pjesë Hoqë e vogel, Bërnjak, Sapniq, Pataqan i Ultë dhe i Epërm, Nushpal, Vrajakë, Bratotin, Drenoc, një pjesë, Senoc, Pastasellë, Polluzhë, Petkoviq etj. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe prej 11093.8 /ha. Ka shtrirje të madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në Veri dhe në Perëndim të Komunës. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecit kapin sipërfaqe prej 596 ha. Ka shtrirje në pjesën JL të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Hoqë e Madhe, Hoqë e Vogël dhe Brestovc. Ndikimet me të larta erozive janë në viset e larta, në toka të zhveshura, me rreth 3200 ha, nga të cilat, 2700 ha janë të pershtateshme për pyllëzim.




Figura 11. Harta e erozionit ne komunën e rahovecit

Vërshimet - Komuna e Rahovecit është e pasur me burime ujore. Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon Drini i Bardhë i cili mbledh të gjitha rrjedhat burimore të këtij territori. Kjo zonë është e rrezikuar nga vërshimet si pasojë e faktorit natyror dhe atij antropogjen. Degradimet e shtratit të lumit, si pasojë e nxjerrjes ilegale të rrës nga shtati i lumit, si dhe nga tokat bujqësore përreth shtatit të lumit janë direkt të ekspozuara vërshimeve. Bimët e vetritura në pellgun lumor si dhe hedhja e mbeturinave të ngurta krijojnë rrezik permanent të të mirave materiale të bujqësisë infrastrukturës dhe vendbanimeve. Nga Kramoviku e deri në Krushë të Madhe janë identifikuar një numër i madh i pikave të nxehta që janë në rrezik të vërshimeve të tokave bujqësore.

Me rreth 30 km gjatësi të Drinit të bardhë, sa kalon nëpër komunën e Rahovecit, rreth 1500 ha janë të rrezikuara nga vërshimet, pa llogaritur se kjo vijë ujore është edhe kufi ndarës në mes komunës së Rahovecit dhe komunave fqinje Gjakovë e Prizren, ku shtrihen edhe tokat më pjellore

të Komunës së Rahovecit . Zonat e rrezikuara nga vërshimet që shtrihen përgjatë shtartit të lumit Drini i Bardhë janë: Xërxa, Malsi e Vogël, Gexha, Denji, Qifllaku dhe Kramoviku. Ndikimet në vërshime vijnë edhe nga degët e lumit të Drinit të Bardhë dhe prrojet për shkak reshjeve të shpeshta intensive. Të rrezikuara nga vërshimet janë këto vendbanime: Fortesa, Sapniqi, Drenovci, Rahoveci, Apterusha, Zoqishti, Retia, Brestovci, Hoqa e Vogel, Nagovci dhe Krusha e Madhe. (të dhëna Komunale).

Zjarret në pyje dhe shpyllëzimi - Zjarret konsiderohen si kategori e fatkeqësive që shkaktojnë shkatërrim të të mirave materiale dhe konsiderohen si fatkeqësi elementare. Janë prezentë zjarret në mjediset e pyllëzuara si pasojë e pakujdesisë së faktorit njeri. Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale me institucionet adekuate formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve. Masat mbrojtëse duhet të kryhen në bashkëpunim me institucionet gjegjëse të qeverisë (MMPH, MBPZHR, MSHP, MEF, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjencioni i Pyjeve etj, si dhe SHPK, FSK, KFOR, Qeveria komunale, Shtabet e krizave, Zjarrfikësit etj). Këto masa janë dhënë si udhëzime për komunat, institucionet e qeverisë dhe institucionet tjera publike. Ato duhet të jenë të organizuara mirë dhe të koordinuara nga institucionet publike siç janë: Shërbimi Policor i Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Zjarrfikësit. Këtu përfshihet edhe KFOR-i si një nga partnerët e komunës. Përgjegjësia e këtyre institucioneve është të ndërmarrin veprime të domosdoshme parapërgatitëse për sigurimin e mobilitetit të njerëzve të involvuar në veprimet që duhet të kryhen. Komuna është përgjegjëse të formoj mekanizma paraprak për raste rreziku dhe duhet të formohet Shtabi i Krizave si dhe të hartohen planet e veprimit në rast rreziku nga zjarri, tërmetet, rrëshqitjet e dheu, epidemitë, ndotje alarmante etj.

Tërmetet - Rreth 43.5% të territorit të Rahovecit shtrihet në zonat me rrezikshmëri nga tërmeti 9 shkallë të rihterit, si dhe rreth 57.5% prej 8 shkallë të riterit. Ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit duhet ti përmbahen shkallës së intensitetit të dridhjeve për minimizimin e fatkeqësisë në raste rreziku. Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+3, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, sidomos urave.

Asetet e Trashëgëmisë Natyrore, Kulturore dhe Turistike - Komuna e Rahovecit se bashku me disa komuna të Kosovës janë të pasura me Lokalitete dhe monumente arkologjike të trashëgëmisë natyrore e kulturore. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Departamenti I Trashëgëmisë Kulturore është institucioni përgjegjës për futjen nën mbrojtje të monumenteve në territorin e Kosovës. Lista e Trashëgëmisë Kulturore përpilohet nga ana e Qendrave regjionale për Trashëgëmi Kulturore (QRTK), që janë në varësi të ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Dhe gajtë hulumtimeve të bëra është hasur në dy lista të cilat më pas kurorizohen me listën zyrtare.

Lista e Objekteve të Evidentuara -paraqet listën e monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren. Në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003.

Lista e Monumenteve nën mbrojtjen e trashëguar nga periudhat e mëparshme (nga pushteti Jugosllav) -e cila është bartur direkt në listën e mbrojtjes. Nga kjo listë në Komunën e Rahovecit gjenden 9 lokalitete në kategorinë Trashëgëmia Arkeologjike dhe 1 monument në kategorinë Trashëgëmia Arkitekturore.

Lista e Trashëgëmisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme -paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë listë, në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej

12 lokalitete në kategorinë Trashëgëmia Arkeologjike dhe 17 monumente në kategorinë Trashëgëmia Arkitekturore. Nga hulumtimet dhe analizat e bëra në terren që janë bërë për 29 monumente që gjenden në Listën e Trashëgëmisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme për vitet 2012-2013. Në listën e fundit të Trashëgëmisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2015-2016) në Komunën e Rahovecit janë përfshirë 18 Monumentenë kategorinë Trashëgëmia Arkeologjike dhe 20 Monumente në kategorinë Trashëgëmia Arkitekturore, duke e rritur numrin total në 38 Monumente.

Tabela 2. Tabela e trashigimis

Kategoria: Trashëgëmia Arkeologjike

Nënkategoria: Monument/Ansambël

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
19.	Kisha e Shortarisë (Manastiri i Zoçishtës)	Mesjetë	Zoçishtë	494/54	003126
41.	Kisha Bërnjaçë	Mesjetë	Bërnjaçë	553/66	003132

Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
150.	Kisha varrezore e Shën Nikollës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	02-237/58	003/28
151.	Kisha varrezore e Shën Gjonit	Mesjetë	Hoçë e Madhe	02-54/58	003/29

152.	Lokliteti Arkeologjik romak në Pozhigë	Romake	Bellacërk	02-460/58	003009
154.	Gërmadhat e Kishës "Shpëtimi i Shenjët"	Mesjetë	Opterushë	558/66	003134
155.	Gërmadhat e Gjytetit	Parahistori, Antikë	Zatriq	998/67	003017
156.	Gërmadhat e kishës së Shën Llukës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	199/67	003000
157.	Kështjella	Antikë e Vonë	Gexhë	02-251/68	002995
242.	Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Vranjak	Propozuar	003427
243.	Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Celinë	Propozuar	003428
244.	Terma-Banjo Romake	Shek.I-IV	Çifllak	Propozuar	003429

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore
Nënkategoria: Monument/Ansambël

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
417.	Teqja Halveti	Shek. XIX	Rahovec	02-251/68	001774
691.	Kullë-Shtëpi e Qamil Vuçitërnës	Shek. XX	Rahovec	Propozuar	001789
692.	Kulla e Hajrulla Qantës	Shek. XVIII	Rahovec	Propozuar	001791
693.	Kroni i Vjetër	Shek. XVIII	Rahovec	Propozuar	001792
694.	Teqja e Melamive	Shek. XIX	Rahovec	Propozuar	001793
695.	Xhamia e fshatit	Shek. XVIII	Zatriq	Propozuar	001798
696.	Konaku i Manastirit të Deçanit	Shek. XVIII	Hoqë e Madhe	Propozuar	003412
697.	Shtëpia e familjes Spasiq	Shek. XIX	Hoqë e Madhe	Propozuar	003413
698.	Xhamia e fshatit	Shek. XIX	Pastasellë	Propozuar	001083
699.	Kulla e Ismet Cmegës	Shek. XIX-të	Rahovec	Propozuar	003414
700.	Minarja e Xhamisë së fshatit	Shek. XVIII-të	Drenoc	Propozuar	001805
701.	Xhamia e fshatit	Shek. XVIII-të	Xërxë	Propozuar	001816
702.	Ura e Gurit	Shek. XIX-të	Bella Cërk (Fortesë)	Propozuar	003415
703.	Sahat Kulla	Shek. XVIII-të	Rahovec	Propozuar	003414
704.	Xhamia e Kasumit	Shek. XIX-të	Rahovec	Propozuar	001769
705.	Xhamia e Sokolit	Shek. XVIII-të	Rahovec	Propozuar	001772

Nënkategoria: Fusha e konzervimit arkitekturor

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
1181.	Fshati Hoqë e Madhe	-	Fshati Hoqë e Madhe	LZVM	-

Monumentet natyrore - Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, geomorfologjik të Komunës së Rahovecit, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore. Në territorin e komunës së Rahovecit shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanjonit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshaj, Monument natyror me karakter hidro- geomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126.5 ha dhe Parku regional i Mirushes 198.77 ha 1983 Monumente natyre me ujëvara te njëpasnjëshme për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës

- Kaznik – Trungu I Frasherit (Francinus excelsior)
- Kaznik – Trungu I Shpardhit (Quercus frainneto)
- Drenoc – Trungu I Shpardhit (Quercus frainneto)
- Nagavc – Trungu I Bungut (Quercus petraea)
- Bratotin – Trungu I Qarrit dhe Trungu I Vidhit (Quercus cerri & Ulmus minor) Trungu I Shpardhit (Quercus frainneto)

Burime të ujit 2 (burime), çerdhe për zogj gjahu 1, Moqalishte 1, Monumente natyrore 1, Varrezat e dëshmorëve/Lapidar 1. Janë hasur edhe gjurmë të kafshëve të egra të mëdhaja grabitqarë të ariut dhe ujkut, shpezë grabitqarë, drunjë të vjetër, puse të ujit për pije etj.




Figura 12. Harta e trashëgimia kulturore dhe natyrore

Parqet kombëtare, sipërfaqet e mbrojtura dhe zonat e veçanta të mbrojtura brenda territorit të komunës

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Rahovecit duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçanta të mbrojtjes : 1. Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, dhe 2. Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe

7. KARAKTERISTIKAT FIZIKO-GJEOGRAFIKE

7.1. Ndërtimi Gjeologjik

Ndërtimi gjeologjik ka kaluar në periudha të ndryshme gjeologjike dhe dy janë fazat kryesore të ndërtimit gjeologjik të nëntokës së komunës së Rahovecit 1. Detare, ku në këtë pjesë ka ekzistuar Deti (Deti Tetis) dhe liqenore ku liqenet neogjenë në hapësira të gjëra të pjesës jug-lindore të Gadishullit Ballkanik kanë qenë të lidhura mes veti 2. Kontinentale: njëra ka ekzistuar në periudhën e hershme gjeologjike në fund të mezozoikut dhe e dyta ku edhe tani ekziston nën ndikimin e fuqive endogjene dhe ekzogjene. Formacionet gjeologjike të Komunës së Rahovecit janë të periudhave:

- Holocen, Pleistocen
 - Pliocen
 - Kretake dhe
 - Jurasike
1. Holocen-formacioni holocen ndërton fundin e luginës së Drinit të Bardhë. Kjo përmbanë material lumor (rërë, zhavorr dhe lym) duke krijuar rrafshje aluvijale përgjatë shtretërve të lumenjve.
 2. Pliocene-Formacionet e pliocenit ndërtojnë pjesën periferike të maleve Zatriq, Kaznik dhe Shkozë, ku përbëhen nga sedimentet liqenore(rërë, zhavorr dhe argjilë).
 3. Kreta-Formacionet e kretakut ndërtojnë pjesën lindore dhe veriore të malit Zatriq si dhe masivi i shkozës që shtrihet në veri, verilindje të qytetit të Rahovecit në drejtim të këtyre fshatrave Hoçë e Madhe, Zaqisht si dhe Apterushë . Ky formacion prezentohet me shkëmbijtë gëlqeror e si shembull është masivi te Ura e Fshejtë (Gradish si dhe në qytetin e Rahovecit).
 4. Jura- prezantohen formacionet diabazike, serpentine, gabrot, ku shkalla e serpentiniteve sillet rreth 70-80 %. Ky formacion përfshinë territor më të madh se formacione tjera, ku kanë shtrirje VVP-JJL.




Figura 13. Gjeologjia e komunës

7.2. Tektonika

Ndonëse komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën qendrore të gropës së Dukagjinit, krijimi definitiv është i lidhur me lëvizjet e reja tektonike të cilat janë zhvilluar në orogenezën alpine. Gropa e Dukagjinit përfshihet në tri zona: Korabit, Gashit dhe e Mirditës. Në zonën e Mirditës shtrihen malet e Hasit, Horsti i Dukagjinit dhe malet qendrore të Kosovës në lartësinë absolute 800-1300 m.

Këto male paraqiten me shkarje dhe rrudhosje. Në këto shkarje aktiviteti tektonik është i shprehur edhe në shpërthime të materialit vullkanik nëpër plasa të tyre dhe janë formuar masivi ultrabazik i malit Zatriq dhe Kaznik. Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC 61 Përgatiti: Data GIS consulting Nëntor 2011 Mali i Zatriqit, Kaznikut dhe i Shkozës ndërtojnë pjesën e Horsti t të Dukagjinit. Relievi i sotëm është formuar me ndikimin e lëvizjeve tektonike dhe të proceseve

erozive. Vijat e përgjithshme morfologjike (lartësi, anët e rrëpijta, çarjet etj, me të cilën shprehet reliefi inicial i malit të krijuar me lëvizjet radiale në fazën e orogjenezës shkarje.

Në aktivitetin tektonik kanë dominuar lëvizjet tektonike zbritëse të zhvilluara përgjatë plasave të vjetra të cilat janë përcjellë me aktivitet vullkanik. Përmbysjet e kësaj zone kanë vazhduar deri në mbarim të kretakut dhe në fillim të paleogjenit dhe të miocenit të vonshëm. Në këtë kontekst është krijuar baseni i Pejës, Rahovecit si dhe të Mirushës, në drejtim të shtrirjes VVP-JJL me që rast është krijuar edhe Horsti i Dukagjinit Mali i Shkozës, Zatriqit dhe Kaznikut paraqesin një renditje morfologjike të Horstit të Dukagjinit të maleve të gjëra 10 km dhe të gjata 20 km. Maje të thepisura janë të theksuara anëve të prera dhe në pjesën më të madhe janë të zhveshura. Janë të formuara nga formacionet gëlqerorë dhe serpentineve dhe dallohen me konfiguracion intensiv të shkëmbinjve dhe formave të ndryshme të çarjeve nëpërmjet të cilave bartet materiali rezidual, kështu që toka është në formë të skeletit, ndërsa terreni i thepisur në formë karstike dhe me mungesë të sasisë së mjaftueshme të ujit. Komuna e Rahovecit disponon përbërje të shumëllojshme gjeomorfologjike. Në veri shtrihen malet e Zatriqit dhe Kaznikut, përbërja e të cilit është nga serpentinët dhe perioditet e serpentuara, diabazet, dollomitet, filetet nga periudha e Jurasikut. Gabrot, senoni, turoni, (në veri) dhe konglomeratet, zhavorri dhe rëra në teracat lumore të vjetërsisë pleistocene në të cilat paraqiten edhe mergele dhe argjila me thëngjill. Vendbanimi i Rahovecit është i shtrirë në teracën liqenore në të cilën prroi Vrella ka formuar shtratin e tij dhe në këtë mënyrë ka formuar luginën e rrethuar nga të gjitha anët me shpatije, në të cilat sipërfaqe tani zhvillohet vreshtaria, dhe kulturat tjera, si dhe janë ngritur objekte banimi. Terreni rreth Rahovecit është i përbërjes së ndryshme gjeologjike, ndërsa në pjesën veriore dhe veri-lindore shtrihen formacionet gëlqerore dhe sedimentet të shkumësit në malin e Shkozës. Pjesa më e madhe e terrenit ku shtrihet vendbanimi i Rahovecit është e përbërë nga mergeli, argjila, rëra dhe zhavorri i vjetërsisë pliocene. Terrenet në afërsi të vendbanimit janë të përbërjes së njëjtë gjeologjike. Nga pjesa e jugore terreni hapet nga Anadrini dhe lugina e Rrafshit të Dukagjinit, nga pjesa veri – lindore e mbyllë mali i Shkozës, ndërsa nga pjesa veriore maja e Zatriqit (1039 m). Terrenet në të cilët është i vendosur vendbanimi si dhe ato në të cilët ai zgjerohet më tutje gjenden në zonën e ekspozicionit jug-perëndimor. Pjerrtësia e terrenit lëshohen kah jug-perëndimi (pjesën e re të vendbanimit) si dhe terrenet në të cilën do të zgjerohet më tutje, gradualisht lëshohen në drejtim të rrafshinës aluviale të përroit të Vrellës e në drejtim të lindjes dhe jugut të kësaj rrafshine. Kushtet më të përshtatshme gjeomorfologjike për zgjerimin e mëtejshëm të vendbanimit shtrihen në pjesët e luginës dhe rrafshinës aluviale të përroit të Vrellës nga drejtimi jugperëndimor.

7.3. Karakteristikat Pedologjike

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nënlloje, në formë të një mozaiku. Me përjashtim të tokave skeletore, tokat tjera janë nga supstratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve të ujërave. Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e kulturave të shumëllojshme. Në këtë rast është me rëndësi ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpeshherë mund të shprehet negativisht nëse nuk i përshtatet lloji i kulturave llojit të tokës, sepse shfrytëzimi jo racional shkakton erozion dhe shkatërrim të tokave.

Në bazë të hulumtimeve në terren dhe hulumtimeve laboratorike të tokave në Komunën e Rahovecit dallohen këto lloje:

Tokat Aluvijale – kanë rëndësi të madhe për bujqësi në territorin e komunës së Rahovecit. Ky lloj i tokave është i përqendruar në luginën e lumit Drini i Bardhë. Këto toka janë formuar në teracat lumore të vjetërsisë aluviale. Duke u larguar nga shtrati i lumit këto toka ndryshojnë përbërjen duke i'u shtuar sasia e humusit. Këto toka janë të klasat të I-rë të bonitetit dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësor.

Gjatë vërshimeve dheu bartet me erozion, kështu që këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike.

Në bazë të hulumtimit laboratorik dhe në terren këto toka ndahen në nënlojet të tokave aluviale: rëra, rëra deltinore, rëra argjilore. Aluvijumi Rënor - këto toka shtrihen përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë, ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Gexhë. Aluvijumi Argjilor - më së shumti është përqendruar në tërë gjatësinë e lumit të Drinit të Bardhë i cili kalon në territorin e komunës.

Tokat Deluviale – kanë pjesëmarrje të vogël në komunën e Rahovecit. Tokat Deluviale Deltinore - shtrihen rreth këtyre fshatrave: Kaznik, Drenoc, Rahovec dhe Zatriq. Aluviumi dhe deluvijumi deltinor – këto toka posaçërisht janë të përqendruara në luginat e ngushta të prrojeve, prorskave në pjesët kodrinore të komunës. Sipërfaqet kryesore të kësaj toke janë të përqendruara në ngastra të këtyre fshatrave: Bërnjak – Rahovec, Fortesë – Sapniq, Apterushë – Reti e Ulët. Tokat livadhore – deltinore - sipërfaqet e tokës livadhore-deltinore shtrihen kryesisht në luginën e Drinit të Bardhë. Rendëzinat – zënë sipërfaqe të konsiderueshme të komunës dhe posaçërisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë e këtyre tokave është thellësia e vogël e shtesës prej 0 50 cm dhe e pasur me humus (5 – 15%) ndërsa më së shumti janë të mbuluar me pyje dhe kullosa. Boniteti i këtyre tokave është i klasat të IV dhe VI-të dhe kërkojnë masa të posaçme për mbrojtjen nga erozioni. Redimentet janë të ulëta dhe kërkojnë masa përmirësuese në mënyrë që të mundësojnë një prodhim të sigurtë dhe racional. Në komunën e Rahovecit janë prezentë edhe këto nënloje të tokave:

- Rendzinë e hinjtë – kafe me substratet gëlqerorë të butë
- Rendzinë tipike – në substratate gëlqerore Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC 64 Përgatiti: Data GIS consulting Nëntor 2011
- Rendzinë e hinjtë – me supstratet gëlqerore
- Rendzinë tipike – mbi serpentine
- Rendzinë e hinjtë – kafe mbi serpentine
- Rendzina tipike dhe e hinjtë-kafe në serpentine

Këto llojet shtrihen ose janë në pjesët veri-perëndimore të komunës, rreth këtyre fshatrave; Drenoc, Zatriq, Kaznik, Guri Kuq, Mrasor e tjerë.

Tokat Smonicë. Ky tip i tokës përfshinë pjesën dërmuese të territorit të komunës së Rahovecit. Këto toka, së bashku me tokat aluvijale, paraqesin, sipërfaqet bujqësore të kësaj komune.

Smonicat e erodura- Sipërfaqet e këtyre tokave shtrihen në lindje të Rahovecit. Në pjesët kodrinore erozioni ka bartë pjesën më të madhe të tokës humusore. Këto toka janë të thellësisë mesatare dhe të cekta, me përbërje argjilore, me përbërje karbonatike të ndryshuar, me reaksion neutral e të dobëtë alkal, me përmbajtje të zvogëluar të humusit si dhe me përbërje të ndryshuar të formës aktive të fosforit dhe kaliumit. Këto sipërfaqe nuk mund të përdoren për të gjitha kulturat bujqësore. Këto sipërfaqet janë të bonitetit të klasës III-të dhe IV-të. Në territorin e kësaj

komune dallohen këto nënllaje Smonicë e pakarbonizuar -Areali kryesor me Smonicë të pakarbonizuar shtrihet rreth fshatrave: Palluzh, Denjë, Bratotin, Dabidol.

Smonicë në proces të kafenjizuar dhe Smonicë e kafenjizuar- Përfshinë një pjesë të vogël të komunës në veri-perendim, ndërmjet fshatrave Kramavik dhe Guri Kuq te Saroshi e tjerë. Areali kryesor i kësaj toke shtrihet në ngastrat e këtyre fshatrave: Nashpal, Sapniq, Bërnjak, Reti dhe komunën kadastrale të Rahovecit. Smonicë e lesivuar me pseudoglej -Sipërfaqet kryesore shtrihen në perëndim të territorit të komunës, në lindje të fshatit Dabidol, Denjë, Ratkoc dhe Malsi të Vogël. Smonicë e eroduar -Në territorin e kësaj komune paraqiten së bashku me tokat të lesivuara, me proces të kafenjezuar.

Sipërfaqet kryesore në këtë nënllaj të smonicës të eroduar janë rreth këtyre fshatrave: Pataçan i Epërm, Pataçan i Ulët, Bernjakë, Reti, Nagac, Celinë etj Tokë e Kuqe mbi formacionet gelqerore - Kompleksi kryesor i këtyre tokave ndodhet në lindje të komunës, rreth fshatrave Apterushë dhe në Zatriq.

Toka e kuqe e cekët mbi formacione gëlqeror -Përfshinë një sipërfaqe të vogël në komunën e Rahovecit dhe atë në veri-lindje të fshatit Apterushë. Toka e kuqe e kafenjizuar mbi formacione të forta -Ky lloj i tokave paraqitet vetëm në Gradishtë te Ura e Shenjtë dhe zë sipërfaqe të vogël. Tokë e kuqëremtë rënore, deltinor mbi sedimentet të kuqërremt -Ky lloj i tokës është e përqendruar në vetëm disa hektarë në jug-lindje të Rahovecit, rreth fshatit Hoçë e Madhe. Paraqitet në pjesët kodrinore dhe atë në lartësitë mbidetare rreth 500 m.

Tokë e kuqe kafe e lesivuar mbi sedimentet e kuqëremtë -Kjo lloj toke është e koncentruar në sipërfaqet e komunës së Rahovecit, rreth fshatit Krushë e Madhe.

Tokë e kafenjhtë deltinore mbi argjilë liqenore-Kjo lloj toke përfshinë pjesët prej malit të Shkozës dhe duke zbritur kah Drini i Bardhë, posaqërisht përshinë sipërfaqet e konsiderueshme kah jugu dhe jug-lindje e Rahovecit dhe Hoçës së Madhe deri te Fortesa dhe Celina. Lartësia mbidetare e këtyre tokave është rreth 450 m.

Shkëmbinjtë ultrabazik -Kjo tokë nuk ka rëndësi të madhe për bujqësi për komunën e Rahovecit. Përshinë Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC 65 Përgatiti: Data GIS consulting Nëntor 2011 sipërfaqe të vogël dhe atë rreth fshatit Drenoc dhe Zatriq. Kjo hapësirë është e mbuluar me pyje dhe kullosa. Tokë pseudogleje - podzol -Në territorin e komunës së Rahovecit kjo lloj toke përfshinë sipërfaqe të vogël në jug-perendim të komunës dhe atë në fshatin Xërxë. Tokë pseudogleje - argjilore- Kjo lloj toke përfshinë pjesën më të vogël të komunës dhe atë rreth fshatit Kramovik.

Shkëmbinjtë-Sipërfaqe nën shkëmbijë ka posaqërisht në pjesët kodrinore-malore të komunës, rreth fshatit Koznik dhe Zatriq. Këto janë sipërfaqe joproduktive. Një pasqyrë më e çartë mbi shtrirjen e llojeve të tokave është paraqitur në tabelën në vijim.




Figura 14. Boniteti i tokave

7.4. Karakteristikat Hidrografike


Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, pusët, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme, si dhe prrojet. Burimet – janë format të rëndësishme hidrografike. Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e prockave – prrojeve dhe rrëzë kodrinve. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jugperëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriq dhe Kaznik.

Shtrirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujrrjedhave si dhe burimeve ujore si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishti, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasella, Kramaviku e tjerë.

Tabela 3. Vendburimet

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Apterushës	400	40	13
Burimi i Zaçishtit	415	15	13
Burimi i H.Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, të gjitha përroskat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe në pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës. Lumenjtë-përroskat të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Ratkoc, Rimnik, Palluzhë, Hoçë etj. Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit është e gjerë rreth 2 deri 5 km. Ndërsa gjerësia mesatare e shtratit të lumit prej 50 deri 100 m, thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m. Hapësira nëpër të cilën kalon lumi është e emruar. Lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishin, duke formuar Grykën (Kanonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në kanjon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra dhe lartësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m. Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe, në lartësi mbidetare 420 m, dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindolit dhe disa burime, ndërsa dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhle buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhlee, Vrellë dhe Sopot) dhe bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegoja që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur. Lumi Rimnik buron në rrëzë të malit Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me rrjedhën Duhllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpal, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës thahe dhe mund të quhet si lumi i Thatë. Duhet cekur se janë edhe disa lumenjprocka si: Ratkocit, Kramovikut, Palluzhës e tjera.



7.5. Karakteristik Seizmike

Sa i përket sizmicitetit Kosova llogaritet si njëra prej zonave sizmike aktive, nga e cila rrjedhimisht, priten termete me shkallë të lartë. Duke u bazuar në të dhënat sizmike nga e kaluara e deri me sot, territori i Kosovës, por edhe i komunës së Rahovecit, kanë qenë të përfshira nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton. Por, në raste të veçanta, lëkundjet janë ndier edhe nga territoret fqinjë të Kosovës kur ka pasur ndonjë vatër të tërmeteve. Sipas Hartës sizmike të Kosovës komuna e Rahovecit bënë pjesë në dy shkallë të intensitetit sizmik prej VII - IX shkallë të Merkalit ose VI shkallë të Rihterit, që karakterizohet me intezitet mjaft të fortë me shkatërrim të mureve bazave të ndërtesave etj.




Figura 15. Harta Seizmike e komunës Rahovecit

7.6. Karakteristikat Klimatike

Faktorët më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në klimën e kësaj hapësire janë: pozita e përshtatshme gjeografike, largësia e vogël e Rahovecit nga Deti Adriatik (102 km deri te gryka e derdhjes së lumit Drinit të Bardhë në detin Adriatik), lartësia mesatare mbidetare (rreth 308 në luginën e lumit të Drinit të Bardhë te Krusha e Madhe dhe 1.039 në majen e Zatriqit, që do të thotë mesatarja 550 m në tërë sipërfaqen e komunës), barriera e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, zhvillimi i mirë i botës bimore dhe shtazore (livadhet, kullosat, të mbjellurat dhe pyjet) etj. Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë si dhe në këto vendbanime: Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë, Xerxë, Gexhë, Ratkoc dhe Çifllak. Ndikimet vërehen gjithashtu edhe rreth luginave të lumenjve, teracave liqenore, lumore dhe të cilat kodrat i mbrojnë prej erërave dimrore të veriut, ndërsa këto vendbanime janë: Reti, Apterushë, Hoça e Madhe, Hoça e Vogël, Brestoc, Rahovec, Bratotin, Dejnë, Pataçan i Epërm dhe i Ulët. Këto janë edhe pjesët më të ngrohta të Anadrinit. Klima me ndikim kontinental ndikon në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës. Pasqyra e shkurtër e të dhënave meteorologjike për komunën e Rahovecit. Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,68 0C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin Korrik prej 38,5 0C, ndërsa minimumi në muajin shkurt me -14,50C. Reshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale janë 609,9 mm.

Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7 ditë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjegull prej 19.7 ditë apo 5,4 %.

7.7. Erërat

Në Rahovec më së shpeshti fyejnë erërat prej veri-lindjes (62 %), perëndimit (50%), nga lindja (17%), jugut (14 %) dhe ndërsa më së paku fryjnë nga veriu (11,8 %), dhe jug-lindja (4 %). Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini Bardhë. Klima është mjaftë e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.




Figura 16. Shpejtësia mesatare e erës në m/sec në Rahovec.

7.8. Flora dhe Fauna

Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (*quercus cerris*), dhe bingu me rreth 80 %, ahu (*fagus sylvatica*), shkoza (*carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, dëllinja etj. Janë prezente edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si dhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë të çajit që njihen si çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypericum perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*) etj. Në territorin e kësaj komune ka fare pak pyje gjethembajtëse. Hapësira e rrafshët e komunës

është shumë pak e mbuluar me druj, ndërsa zakonisht rritet shelgu (*salix alba*) në brigje të lumenjve. Bimë të ulëta ka mjaft si: lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*), formacionet e livadheve (tërfilli) dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë. Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (*canis lupus*), dhelpra, lepur (lepus europaeus), iriqi (*ernaceus europeus*) etj. jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bermanni*). Llojet e peshqve janë të shumtë. Në lumin Drini i Bardhë jetojnë 18, ndërsa llojet më kryesorët janë: trofta, mustaku , mlyshi, ngjala, krapa etj. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (*lucanus cervus*) etj. Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (*parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*columbia livia*), qukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*) qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezët grabitçare që jetojnë në këtë territor janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petriti (*malco tinnunculus*). Shpezët shtegtare që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në dy sektorët është rreth 10800 ha , ku sektori privat ka rreth 1500ha dhe ai publik 9300 ha . Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Rahovecit është e mbuluar me pyje rreth 6065 ha, ndërsa 3205 ha janë sipërfaqe malore e zhveshur. Degradimet e pyjeve janë dukuri sikur në çdo pjesë të Kosovës, e sidomos prerjet ilegale, ku rreth 2200 ha në bazë të dhënave komunale rezultojnë si të degraduara . Pasuritë pyjore shtrihen në veri - perëndim të komunës (Zatriq, Petkoviq, Kaznik etj.) Dallohen me formacione ahu (*fagus sylvatica*), qarri (*quercus cerris*), bungu, shkoza (*carpinus orientalis*), brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj.




Figura 17. Harta e pyjeve, kullosat dhe livadhet në komunën e Rahovecit

7.9. Peizazhi

Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Siç është përshkruar më lartë, lokacioni ku është planifikohet të ndërtohet impianti i seperacionit gjendet në një lokacion ku janë të përhapura një numër i konsiderueshëm i veprimtarive minerare. Ky është një lokacion në veri të qytetit të Rahovecit dhe nuk parashihet që do të sjellë ndonjë problem. Sipas vizitave në teren në këtë lokacion tani më veç që ka pësuar një ndryshim të vrazhdë peizazhi nga faktori njëri.

Në fotot më poshtë është paraqitur gjendja reale e lokacionit se ku do të ndërtohet impianti. Është më se e qartë që pasi të ndërtohet ky impiant zona do të marrë një karakter ndryshe dhe do të jetë më e bukur në kuptimin e pamjes.

Si përfundim e këtyre argumenteve që u prezantuar, mund të themi që ky projekt nuk paraqet ndonjë kundërshtim, konflikt apo pa paanshmëri në kuptimin peizazhi.



Figura 18. Pamje e lokacionit ku do te vendoset seperacioni.

8. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Në këtë kapitull, informacioni mbi vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale është i organizuar në nën-kapituj për secilin burim/receptor mjedisor të ndikuar. Qëllimet e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të ndikimit janë:

- Identifikoni ndikimet e mundshme negative dhe të dobishme mjedisore dhe sociale bazuar në njohuritë e regjimit të ndërtimit dhe funksionimit të Projektit dhe informacionit bazë në Zonën e Studimit.
- Vendosen propozime të projektimit për të lehtësuar ndikimet e pafavorshme dhe për të rritur ndikimet e dobishme.

Ky identifikim dhe vlerësim i ndikimit u bazua në kërkesat e ligjeve të Kosovës. Opinionet e palëve të interesuara të marra gjatë aktiviteteve të angazhimit janë marrë gjithashtu në konsideratë. mDuke i pasur parasysh specifikat e projektit ndikimet ne mjedis mund lajmërohen ne të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative ne mjedis i klasifikojmë si:

- ndikimet gjatë fazës së përgatitjes dhe ndërtimit të seperacionit me njesit përcjellëse
- ndikimet gjatë fazës së operimit te seperacionit
- ndikimet gjatë fazës pas ndërprerjes se punës.

Në lokacionin e planifikuar për ndërtimin e seperacionit, ndikime ne mjedis mund te ketë nga procesi teknologjik, te mundshme ne ujera, ajër dhe toke – zonën përreth.

Projekti do te kujdeset qe këto ndikime te jene te përmasave te pranueshme për mjedisi, sipas standardeve - limiteve te lejuara.

➤ **Ndikimet në mjedis - gjatë fazës se ndërtimit**

Në periudhën e ndërtimit ndikimet në mjedis mund të jen nga:

- ❖ ndotja e ajrit ne raste te emisionit te gazrave, të cilët lirohen gjatë djegies te derivateve në motorët e automjeteve dhe mekanizmin e rënd.
- ❖ ndotjen e ajrit me lirimin e pluhurit ne vend punishte gjatë punës së mekanizmit dhe paraqitjes së erërave.
- ❖ ndikimi i zhurmës ne mjedis që lajmërohet gjatë punës së mekanizmit dhe aktivitetit për montimin e pajimeve.

➤ **Ndikimet në mjedis - gjatë operimit**

Ndikimet negative potenciale ne mjedis të shprehen si:

- ❖ ndikime ne kualitetin e ajrit
- ❖ ndikime ne kualitetin e ujit
- ❖ ndikime ne tokë
- ❖ ndikimet e zhurmës ne mjedis
- ❖ ndikimet ne florën dhe faunën
- ❖ ndikimet ne mikroklimë

Ne vijim do të analizohen të gjitha ndikimet potenciale ne mjedis.

8.1. Ndikimet në ajër

Intensiteti i ndikimeve në ajër varet nga procesi teknologjik i separacionit, lëndës së parë, kushteve klimatike dhe karakteristikave geomorfologjike të terrenit. Në kualitetin e ajrit në hapësirat punuese dhe në rrethinën e lokacionit mund të ndikojnë:

- Ndikimet në ajër gjatë fazës së vendosjes së separacionit do të jenë deri sa të vendoset separacioni, ku do të shoqrohet kjo fazë me zhvendosjen e një mase shkembore për rrafshimin e platos së separacionit dhe levizja e këtyre makinerive do të ketë ndikime në ngritjen e pluhurit.
- Separacioni – Kjo është faza e operimit që më së shumti mund të rezultojë me emisione të pluhurit, për shkak se makineritë do të jenë vazhdimisht aktive. Në këtë pjesë teknologjike, pluhuri mund të emitohet në disa hallka: a) bluarja, b) transferim me shirit transportues, c) fraksionizmi, d) ngarkimi i materialit final të fraksionuar në kamion transportues.
- Emisione nga motorët me djegie të brendshme. Ndikime në ajër do të rezultojnë edhe nga gjeneratorët për prodhim të energjisë elektrike për funksionim të separacionit (në rast se nuk ka energji), si dhe nga makinat operuese, si eskalator, buldozer, kamion.

Gjatë gjithë këtyre fazave të procesit teknologjik, nga ku lirohen grimca të pluhurit, këto grimca emetohen në ajër, dhe pastaj për shkak të peshës së tyre gravitojnë në tokë, në afërsi të impiantit, ose varësisht prej erës mund të transferohen në mjedisin përreth.

Në kushte të mos ndërmarrjes së masave zvogëluese, si rezultat i reliefit dhe kushteve tjera mjedisore, këto grimca mund të barten edhe në distanca më të largëta. Nivel më pak relevant i ndotjes së ajrit mund të vijë edhe nga emisionet e gazrave të automjeteve që përdoren, si lugë ngarkuese kamion etj. Marrë në tërësi, gurëthyesit janë ndotës të mëdhenj të ajrit me thërmia të ngurta. Shkalla e rrezikshmërisë është edhe më e lartë kur merret parasysh përbërja kimike e pluhurit, sidomos prezenca e metaleve të rënda. Shikuar nga aspekti i përbërjes granulometrike pluhuri i liruar nga separacioni i takon fraksioneve të imta të rrës e cila në gjendje të thatë bartet dhe përmes erës lëvizë në hapësira më të mëdha. Pluhuri lirohet, pothuajse në të gjitha fazat e procesit të përshkruara më lartë, prandaj edhe konsiderohet ndikimi kryesor i këtij aktiviteti.

8.2. Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë sipërfaqësore mund të ndryshojnë si rezultat i aktiviteteve të projektit, gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit.

Në procesin teknologjik për separimin e gurit gelqeror nuk përdoret uji në sasi të mëdha, dhe prandaj nuk do të kemi ujë të ndotura industriale (*uji përdoret vetëm në kohë të nevojshme për arsyje të mos lejimit të ngritjes së pluhurit gjatë procesit të separimit*).

Në hapësirat e impiantit mund të ketë ndotje gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit, të cilat janë:

- ❖ Ndikimi më i madh në cilësinë e tokës do të vijë në rast të përdorimit të makinerive të vjetruara, për shkak të rrjedhjes së vajrave apo karburanteve dhe në rast të pa përgjegjësisë të stafit, gjatë shtimit të karburantit apo vajrave në makineritë në zonë, apo gjatë proceseve servisuere.

- ❖ Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga stafi / punëtorët.
- ❖ Depozitimi i pluhurave të rezultuara si dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta që mund të përdoren në zonë.
- ❖ ujërat e ndotura sanitare dhe fekale, (faza e operimit).
- ❖ rrjedhje dhe derdhje aksidentale të karburantit, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme në zonat e depozitimit të produkteve dhe mbeturinave.
- ❖ rrjedhje dhe derdhje aksidentale të karburantit dhe lubrifikantëve nga makineritë e ndërtimit dhe automjetet në vendin e operimit, këto ujera janë mjaftë të turbullta dhe të yndyrshme, prandaj ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

8.3. Ndikimet në tokë

Toka si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është element për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produkimit dhe ndërtimit të materieve), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor. Toka është e domosdoshme edhe për funksione teknike në këtë rast për ndërtimin e seperacionit.

Në aspektin e ndotjes së dheut dallojmë dy faza edhe atë periodën gjatë ndërtimit dhe periodën gjatë operimit.

Fazë te ndërtimit - gjatë fazës te ndërtimit ndikim negativ në tokë paraqitet nga deponimi i dheut të gërmuar për bazamente, si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët.

Po ashtu do te ketë ndikime edhe nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor.

Fazën e operimit - në fazën e operimit, ndotja e dheut mund të ndodhë si pasojë e vendosjes të pakontrolluar të vajrave dhe lubrifikanteve të përdorur, gjatë përdorimit të pajisjeve makinerie, si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e hapësirave punuese dhe nga fundërrimit të komponentëve ndotëse nga ajri.

Kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë operimit pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vije si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve.

Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin.

Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqet operuese, konfiguracioni i ternit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e krijohe nga automjetet transportuese.

8.4. Ndikimet e zhurmës ne mjedis

Me termin zhurmë nënkuptojmë çdo tingull niveli i të cilit kalon vlerat e caktuara me ligj. Zhurma krijohet nga automjetet transportuese, mekanizmit dhe pajimeve gjatë punës të seperacionit, gjate fazës se ndërtimit dhe operimit.

Koha e veprimit të zhurmës është në funksion të angazhimit të pajimeve, gjegjësisht orarit të punës. Në lartësinë e zhurmës ndikojnë rrjetat e pa forcuar dhe të dëmtuara, lidhëset filetove, saldimet e pëlcitura, mos lubrifikimi i kushinetave, vibrimet e sitave, shtrëngimi jo i rregullt i lidhëseve (rrypav) etj.

Për arsye të zvogëlimit të nivelit të zhurmës në përputhshmëri me mundësit teknike duhet në mënyrë kontinuele të përcillen këto burime potenciale të krijimit të zhurmës.

Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Ne këtë rast vendbanimet janë ne distance te konsiderueshme dhe zona eshte e mbushur me aktivitete te njeta qe veprojnë.

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik, nga makinat gjatë procesit të ngarkimit, transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese e ngarkuese që janë prodhime të reja niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde.

Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk do të kaloj 50 dB, kurse gjatë natës gjithashtu nuk do tejkalohet niveli 45 dB.

Tabela 3. Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db -niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

8.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar ku do te ndërtohet impianti nuk do të kemi keqësim shumë të madhe të apo zhdukje të mëdha të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe nën hapësirat punuese kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet që të ketë ndikime të mëdha negative ne faunën, që do të thotë se nuk kemi zhdukje të faunës, përveç largimit të faunës nga rrethina e ngushtë e lokacionit të lartpërmendur.

Vlen te ritheksohet se hapësira ku do te ndërtohet ky impiant i është ka pasur ndërhyrje ne aspektin e florës dhe faunës.

8.6. Ndikimet në mikroklimë

Zhvillimi i procesit teknologjik kryhet në kushtet mjedisore të temperaturës dhe ajrit, prandaj nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në ndryshimet mikroklimatike, në rrethin të ngushtë dhe të gjerë për arsye së emisionet e nxehtësisë janë të pa përfillshme. Gjatë procesit teknologjik

pluhuri i cili lirohen në atmosferë nuk kanë temperaturë dhe nuk ka të bëjë me vlera të mëdha sasiore, ky pluhur nuk do të ketë ndikime në mikroklimën e rrethinës të lokacionit.

8.7. Ndikimet në peizazh

Ndikimet e parashikuara në peizazh do të vijnë nga prania e elementëve të rinj që do të ndryshojnë peizazhin, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë. Ndryshimet e përkohshme në përgjithësi do të shoqërohen me praninë fizike të punëtorëve dhe makinerive dhe materialeve të ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit, me ç'rast ndikimet e përhershme do të shoqërohen me elementët strukturorë të ndërtuar të objekteve. Efektet në peizazh fillojnë në fazën e ndërtimit, por ato vazhdojnë gjatë fazës së funksionimit.

Në këtë pjesë, ndikimet gjatë fazës së ndërtimit i referohen atyre që kanë karakter të përkohshëm. Ndikimi afatgjatë në peizazh analizohet si pjesë e fazës së funksionimit.

Faza e ndërtimit - Ndryshimi i peizazhit nga prania e punëve ndërtimore, kampeve të ndërtimit dhe lehtësirave të tjera ndihmëse. Aktivitetet kryesore të fazës së ndërtimit që parashikohet të kenë efekte afatshkurtra në peizazh përfshijnë:

- Vetë trualli i ndërtimit, ku prania e punëtorëve, makineritë e rënda, lëvizjet e tokës, depozitat e materialit ndërtimor, grumbujt e mbeturinave, toka lakuriq, etj., Do të dëmtojnë peizazhin lokal, veçanërisht për banorët e afërt. Kjo dëmtim i peizazhit do të zhduket pas te përfundoj ndërtimi.

Mbetjet e ngurta do të gjenerohen gjatë ndërtimit të Projektit. Sasi të konsiderueshme të materialeve shkëmborë dhe tokës mund të gjenerohen nga lëvizja e tokës, te cilat me vone mund te seperohen.

Madhësia e ndikimit në peizazh parashikohet të jetë e vogël gjatë fazës së ndërtimit, për faktin se aktiviteti e lartpërmendura nuk pritet të vëzhgohen nga një numër i madh i njerëzve; ata do të zënë shtrirje të kufizuar të tokës, do të kenë dimensione relativisht të vogla dhe do të vendosen brenda parcelës punuese.

Faza e funksionimit - Ndryshimi i peizazhit nga prania e impiantit me objektet tjera do te jete pas fazës se ndërtimit. Me zbatimin e Projektit, ndikimet e peizazhit lindin për shkak të:

- paraqitja e formave lineare dhe gjeometrike,
- Ndryshimet e karakteristikave të peizazhit, për shkak të heqjes së mbulesës vegjetative dhe përdorimit të materialeve të ndërtimit me karakteristika,
- krijimin e prerjeve dhe argjinaturave.

Këto ndryshime në modelin natyror të peizazhit vlerësohen në lidhje me:

- Intensiteti i veprimeve ndikuese, i vlerësuar nga madhësia dhe ekspozimi ndaj shikimit të banorëve lokalë, vizitorëve dhe udhëtarëve
- Dobësia (dukshmëria) vizuale, e vlerësuar nga vendndodhja dhe numri i shikuesve.

Madhësia e ndikimit të veprimeve të projektit është vlerësuar bazuar në ndjeshmërinë e njësive peizazhore të prekura, intensitetin e aktiviteteve të projektit dhe numrin e vëzhguesve të mundshëm të peizazhit në zonën ku zhvillohet veprimi i projektit.

Prodhimi i mbeturinave të ngurta gjatë operimit dhe aktiviteteve të mirëmbajtjes mund të përfshijnë mbeturinat e rivendosjes në parcele (p.sh. grumbullimi i materialit teprice gjate procesit teknologjik dhe derdhjeve te materialit shkëmbore); mbeturina ditore qe krijohen nga punëtorët edhe mbeturina të tjera qe mund te dalin nga ndonjë prishje e impiantit.

Është me rëndësi të ritheksohet se, lokacioni ku do të ndërtohet ky impiant është mjaftë i vrazhde ne aspektin vizual, për arsyeje që kjo hapësira është minierë e hapur që shfrytëzohet shkëmbi gëlqerore.

8.8. Ndikimet në mjedis pas fazës të mbylljes së separacionit

Ndikimet negative në mjedis në fazën pas mbylljes së separacionit mund të ndodhin vetëm në raste kur mbetet ndonjë pjesë e skileteve metalore të cilat me kalimin e kohës mund të korridohen dhe të ndikojnë në mjedis.

Në këtë mënyrë mund të vij gjerë të ndotja e tokës dhe ujërave eventuale sipërfaqësore dhe nëntokësore varësisht nga sasia e oksidimit të hekurit dhe gjatësisë kohore të rrjedhjes dhe depërtshmërisë në tokë. Mirëpo këto mundësi të ndotjeve praktikisht nuk priten për arsye se me ndërprerjen e punës këto materiale në rast se nuk janë të harxhuara, do të largohen dhe përdorën në ndaj vend tjetër se kanë vlerë ekonomike.

8.9. Trashëgimia Kulturore

Territori i Komunës së Rahovecit ka trashëgimi të pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore. Ky territor i përket krahinës së Zatriqit, i cili ka qenë i banuar që nga parahistoria.

Është vendbanim shpellor parahistorik. Periudha e neolitit dhe eneolitit, dëshmohet në vendbanimin shpellor në Zatriq. Gjetjet arkeologjike, sidomos qeramika në këtë lokalitet i përkasin shekujve IV-II para krishtit. Është fortifikata e periudhës së vonë antike. Ky është lokaliteti i vjetër i banuar që nga periudhat me të hershme historike, posaçërisht me popullat iliro-dardane, thuhet që nga shek. VIII-IV p.e.s. Është vendbanim i tipit kodrinor. Gërmadhat e kalasë Gradinës ilire shtrihen në majën e rrafshet të malit shkëmbor ku pulorë, mbi fshatin e sotëm.

Në sajë të pozitës së mirë, ky vendbanim, në aspektin strategjik, ka mbisunduar në rrethin. Në kala shtrihej pjesa e poshtme e qytetit. Furnizimi me ujë i vendbanimit është bërë nga burimi i Qelis, afër Gradishtës, në pjesën veriore. Përveç Gradishtës kryesore, ekziston edhe Gradishta e Vogël, në mahallen e Poshtme. Aty ishte edhe Kulla, ku edhe sot egzistojnë guret. Disa kulla afër këtij vendbanimi, ishin vende për sigurimin e tregtarëve që kalonin nëpër këtë vendbanim. Nëpër këtë vendbanim të njohur të asaj kohe, që ishte qytet i fortifikuar dhe vendbanim me shtëpi të shumta afër tij, kalonte rruga kryesore tregtare që lidhte pjesët e Rrafshit të Kosovës me atë të Dukagjinit dhe me gjere. Kjo dëshmohet me kaldermat e shumta që janë zbuluar afër tij dhe me larg në fshatrat, nëpër të cilat ka kaluar rruga. Si vendbanim është i regjistruar në një hart austriake të hartuar në bazë të shënimeve të vitit 1689. Ishte vend i zotrinjve, agallarëve, ku kanë jetuar në këtë pjesë të Anadrinit. Në kohë të fundit përmendet Bali aga dhe vajza e tij, e cila ka ndërtuar një pjesë të këtij kalldermi. Me emrin Zatriq është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Në vitin 1919 nga pushteti serb u thënë me bajoneta 27 burra dhe një grua me femijë dhe u plaqkit i tërë fshati. Nga ky vendbanim i madh janë shpërngulur shumë familje si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj, si p.sh. në Pejë thuhet se është krijuar lagja Zatra, në prishtinë-Perroi i Zatriqit, pastaj në Ferizaj, Prizren etj. Të shpërngulur ka edhe në Turqi etj. Shënime statistikore: Në vitin 1879, në kuader të Bajrakut të Polluxhës, kishte 89 shtëpi shqiptare: në vitin 1913- 474 banorë: në vitin 1919- 45 shtëpi shqiptare muslimane me 316 banorë: në vitin 1921 - 40 shtëpi me 220 banorë: në vitin 1948 - 64 shtëpi me 457 banorë: në vitin 1953 - 67 shtëpi me 483 banorë: në vitin 1961-70 shtëpi me 560 banorë: në vitin 1981-67 shtëpi me 723 banorë. Sipas vlerësimeve në vitin 1991 ky vendbanim kishte 795 banorë. Para luftës së fundit të vitit 1998/99

fshati kishte rreth 80 shtëpi me 857 banor. Nga agresori serb fshati është djegur në teresi. Është djegur e shkatërruar edhe shkolla e fshatit me dokumentacion, si dhe ambulanca. Xhamia e fshatit është demoluar. Nga ky vendbanim janë vrare 16 persona, prej tyre 3 dëshmor. Me 3 shtator popullata është larguar nga fshati. Disa janë vendosur neper male, disa kohe pas kohe, në fshatra të tjera, kurse disa në Shqipëri. Bazuar në Planin zhvillimore të komunës dhe literaturës shtese që kemi përdorur, në zonë afere lokacionit nuk kemi ndonjë objekte të trashigimis kulturore.

8.10. Ndikimet në popullatë dhe vendbanimet

Lokacioni është në zonën kadastrave Rahovec, mirëpo lokacioni njihet si zonë e fshatit Zatriq dhe shtrihet në një zonë industriale ku gjenden edhe një numër i veprimtarive minerare. Shtrihet në pjesën veriore të Rahovecit me kufirin administrative të Malishevës. Gjatë hartimit të raportit VNM-së, ndër veçoritë kryesore që duhet me i kushtuar kujdes për t'i trajtuar janë edhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaje aktiviteteve, pasi që janë ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Njërin nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullatën dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë dhe hapësirën e analizuar. Si pas vizitave në teren dhe ortofotove të bashkangjitur këtij raporti, objektet banuese janë në një distancë mbi 150 m. Andaj impianti në fjalë nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi në aspektet ambientit dhe ekonomik. Vendbanimet ndodhen në distancë mbi 2 km.



Figura 19. Foto lokacioni të seperacionit.

9. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

- a) Ndërtimi i impiantit nuk pritet të ketë ndikim negativ të medhaja në ambient për arsye se do të bëjë mbulimin e shiritave transportues të zhavorrit dhe do të vendosë sistemin e ujit për mënjanimin e pluhurit. Duke u bazuar në atë se projekti nuk është i natyrës së përhershme, nuk mendojmë se në rast të demolimit do të kemi pasoja shumë të rënda për arsye se projekti është i tipit montazh dhe shumë lehtë mund të demolohet.
- b) Për ndërtimin e objektit, duhet shfrytëzuar sipërfaqja e tokës e po ashtu duhet shfrytëzuar dhe uji i cili është i nevojshëm gjatë ndërtimit edhe pas ndërtimit. Sa i përket ndikimeve përpos që do të ndikojë në nxënien e sipërfaqes së tokës ndonjë ndikim tjetër në tokë mendojmë që nuk do të ketë.
- c) Në Impianti nuk do të ketë emetim të zhurmës në kufijtë e pa lejueshëm për aktivitetet tjera për rreth, e po ashtu edhe të dridhjeve. Pasoja tjera mund të jenë edhe mbeturinat gjatë procesit të ndërtimit dhe funksionimit, mirëpo kompania gjithashtu nuk bëjë ndotje as nga mbeturinat komunale sepse ato i menaxhon në përputhje me ligjin.
- d) Kompania do të marrë të gjitha masat për ruajtjen e shëndetit të njeriut gjatë funksionimit dhe pas përfundimit të projektit, për arsye se objekti i kompanisë do të jetë shumë i qëndrueshëm dhe mund të përballojë fatkeqësive natyrore siç janë tërmetet, erërat dhe vërshimet, ndërsa sa i përket zjarrit kompania do të marrë të gjitha masat për fikjen e zjarrit ku do të piset me aparatet për fikjen e zjarrit.
- e) Sa i përket zonave me rëndësi të veçantë, Impianti nuk rrezikon ndonjë zonë të veçantë apo burim natyror.
- f) Ky projekt nuk do të ketë ndikim të madh në natyrë për sa i përket gazrave serrë, për arsye se kamionët dhe të gjitha makineritë që përdoren brenda në fabrike janë me gazra me të lartë se Euro 4 të cilat lejohen për përdorim dhe se nuk kanë ndikim në cenueshmerinë e projektit dhe po ashtu nuk kanë ndikim në ndryshime klimatike.
- g) Pasojat e mundshme mund të vijnë nga derdha e mbeturinave të cilat lirojnë ujëra të ndotura, prisha e kamionëve, derdha e karburanteve të makinave, nga sistemi elektro-energetik, sa i përket pasojave ndërkufitare nuk ka fare pasoja.

Për sa i përket mbrojtjes së mjedisit kompania do të marrë të gjitha masat për mbrojtjen e Ajrit (nuk do të përdoren makineri të vjetra), ujit (do të shkarkohet në impiant dhe trajtohet) dhe tokës (do të kujdeset që mos të kemi rrjedhje të derivateve në tokë).

10. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERESIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat te cilat janë përdorur për Vlerësimin e pasojave Mjedisore paraqiten si me poshtë:

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike menaxhimi i trajtimit të çështjeve mjedisore. Si e tillë, ajo plotëson dhe përforcon një metodë sistematike në menaxhimin e përgjithshëm të një organizate; dhe organizatat me një menaxhim të shëndoshë përgjithësisht kanë një performancë më të mirë përmes një metode proaktive dhe të përgjithëshme për zgjidhjen e aspekteve të veprimeve të saj. E kundërta e menaxhimit sistematik është reagimi ndaj vendimeve të marrarregullimi i gjërave kur ato prishen, të kuptuarit se si duhet vepruar kur ka një kërcënim të gjobave dhe padive ose kur përballesh nga konkurrentë më të efektshëm. Marrja e vendimeve të shpejta rrallë është një menaxhim i mirë. Në disa raste, organizatat i përfshijnë Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, sepse ata tashmë e kishin një sistem të mirë menaxhimi; në raste të tjera Sistemi i Menaxhimit Mjedisor çon në një menaxhim të përgjithshëm më të mirë duke hapur rrugën përmirësimit të përgjithshëm të veprimeve, dhe futjen e praktikave të mira të menaxhimit aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë. Në rastin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit, ka edhe përfitime të veçanta: kursime në kosto, përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme, përmirësimi i marrëdhënieve me autoritetet, zvogëlimi i rrezikut në aspektin e detyrimeve mjedisore, përmirësimi i motivimit të punonjësve, përmirësimi i shëndetit në punë dhe një performancë më të mirë mjedisore.

Kursime në kosto: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për parandalimin e ndotjes, që në mjaft organizata sjellin kursime financiare. Në një fabrikë prodhimi pa aktivitete të mëparshme mjedisore, shpesh gjysma e ndotjes mund të parandalohet me investime të vogla dhe me procese të thjeshta përmirësimi ose me një qeverisje të mirë të brendshme. Në vendet Evropiane, tarifat e nënshtruara të shkarkimit dhe tarifat për hedhjen e mbeturinave janë shpesh herë mjaft më të larta se kostoja e aktiviteteve për parandalimin e ndotjes, në këtë mënyrë gjëndërohen përfitime financiare. Gjithashtu veprimtaritë dhe teknologjitë për të përmirësuar rendimentin e energjisë, si sistemet efektive të ndriçimit apo gjeneratorët elektrike dhe pompat shpesh janë me leverdi. Kjo do të thotë se ato gjenerojnë kursime në kosto.

Zvogëlimi i rrezikut: Menaxhimi sistematik i rrezikut është një detyrë e përgjithshme për çdo organizatë, dhe një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të mbështetë menaxhimin e rreziqeve nga dhe drejt mjedisit, që mund të parashtrojnë një rrezik për të ardhmen e vetë organizatës, p.sh. nëpërmjet emetimeve që nuk janë të pranueshme për mjedisin ose aksidente që mund të çojnë në detyrime mjedisore ose dëmtim të reputacionit. Shqyrtimi fillestar mjedisor është gjithashtu një vlerësim i rreziqeve mjedisore, duke qenë se ai vlerëson pasojat dhe mundësinë e ndikimeve mjedisore. Plani i veprimtari që rrjedh, dhe aktivitetet e tjera të zbatimit të sigurojnë mjetet për të menaxhuar këto rrezeqe, duke u përpjekur në reduktimin si të mundësive të tyre dhe të efekteve negative.

Përputhje me legjislacionin: Organizatat në Ballkan dhe Evropë, kryesisht ato të përfshira në prodhim, veprojnë në mjedis mjaft të rregulluar: ata duhet të pajtohen më një legjislacion mjedisor të komplikuar. Gjithmonë e më shumë, aktivitetet e rrezikshme për mjedisin kanë nevojë për leje mjedisore. Për një organizatë, pajtimi me legjislacionin mjedisor është një detyrë e rëndësishme, meqenëse mos-pajtimi mund të çojë në detyrime dhe pasoja ligjore për përfaqësuesit ligjorë të organizatës – drejtuesit e lartë të saj. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë ligjore, pasi ato sigurojnë një bazë për identifikimin e legjislacionit të përshtatshëm, kërkesat e zbatueshme dhe kontrollon përputhshmërinë brenda organizatës. Kjo

metodë sistematike me përputhshmërinë ligjore ndihmon gjithashtu në përmirësimin e marrëdhënieve të organizatës me autoritet mjedisore.

Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë: Aktivitetet e organizatave jo qeveritare dhe protestat publike kundër projekteve që mund të dëmtojnë mjedisin, tregojnë se ndryshimet në shoqëri po ndodhin në nivel global dhe lokal. Konventa Aarhus ndihmon publikun që të ketë një zë në vendimet politike që prekin cilësinë e këtij mjedisi, i ofron publikut akses të lirë në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e gjykimit për çështjet mjedisore. “Palët e interesuara” si rezidentë, grupet e interesit, media, klientët dhe çdo lloj grupi tjetër apo individ me interes në një çështje, janë tani pjesë e realitetit të një organizate, dhe mënyra më e mirë për tu sjellë me ta është fitimi i besimit nëpërmjet një informimi dhe komunikimi të rregullt dhe të besuar. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ju ndihmon në përgatitjen e të dhënave dhe informacionit që ju duhen për këtë proces komunikimi, ndërsa certifikatat dhe raportimi i rregullt do të mbështesin procesin e fitimit të besimit.

Përmirësimi i motivimit të punonjësve: Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme: Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e bizneseve. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuara për mjedisin.

11. PERSHKRIMI I MASAVE

Ne këtë kapitull është kryer analiza dhe janë përshkruar masat për parandalimin, zvogëlimin ose zbutjen e ndikimeve negative të impiantit. Masat e përgjithshme të propozuara për zbutjen e ndikimeve negative.

Me qëllim që të parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikime negative mjedisore të projektit gjatë fazës së ndërtimit dhe ushtrimit të tij duhet të merren masat e duhura nga kompania.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit që do të merren ndahen në:

- Teknike dhe
- Organizative

Tabela 4. Paraqitja tabelore e masave teknike dhe organizative

Çfarë	Si
Parandalim	- Përzgjedhja e teknologjisë me cikël të mbyllur në pajtueshmëri me ligjet mjedisore - Instalimi korrekt i makinave - Përzgjedhja dhe trajnimi i personeli për mënyrën e përdorimit të teknologjisë - Kontrolli i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e filtrave - Zbatimi rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj - Përdorimi i naftës me cilësi të lartë - Përdorimi i ujit në procesin e seperimit
Kontroll	- Sigurimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në raste emergjencash. - Lagia e sheshit të punës dhe rrugëve neper të cilat kalojnë kamionët - Lëvizja e ngadalte e automjeteve - Larja e shpeshtë e makinerive dhe kamionëve të punës
Ndërhyrje	- Riparimi i menjëhershëm i defekteve dhe avarive teknologjike imitimesh dhe derdhjes të paparashikuara - Pastrimi i menjëhershëm i derdhjes aksidentale - Njoftimi i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, ambulanca).
Administrim	- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi të të gjithë infrastrukturës dhe makinave sipas rregullave teknologjike.

Zvogëlimi ose zbutja e ndikimeve negative në mjedis në princip arrihet duke i u përmbajtur masave themelore si në vijim:

- marrja në konsiderim e rregullave dhe kërkesave mjedisore gjatë projektimit, ndërtimit dhe të pajimeve, si dhe në rast eventuale të ndërprerjes të punës.
- zvogëlimi i emisioneve të materieve negative në atmosferë gjatë realizimit të procesit teknologjik.
- trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura nga larja e mekanizmit të rëndë dhe pastrimi i hapësirave punuese.
- trajtimin e ujërave të ndotur sanitaro.
- manipulimi i drejt dhe në bazë të rregullave me lëndët e para (fraksionet minerale, vaji ndezës etj).
- grumbullimi dhe trajtimi sipas rregullave të materialit mbeturin.

- zvogëlimi i emisionit të zhurmës.
- aftësimi i të punësuarve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.
- monitorimin mjedisor.
- përdorimi i masave tjera organizative, tekniko-teknologjike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

Me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit nga ky raport, të dokumentacionit projektues dhe akteve ligjore dhe nënligjore mjedisore, do të arrihet që pajimet për prodhimin me objektet përcjellëse në këtë lokacion nuk do të ketë ndikime negative në mjedis dhe kushtet mjedisore nuk do të përkeqësohen, gjegjësisht mjedisi nuk do të ndotet mbi vlerat standarde dhe kërkesave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit në këtë raport.

Analiza e masave për mbrojtjen e mjedisit është kryer në bazë të ndikimeve negative të mundshme në mjedis dhe atë në ajër, ujë, tokë, zhurmë, florë dhe faunë, mikroklimë, popullatë etj.

11.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Masat zbutëse gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë zbatimin e Planit të Menaxhimit të Pluhurit dhe Planit të Menaxhimit të Trafikut të Ndërtimit.

Masat shitesë zbutëse që do të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit janë këto:

- Mirëmbajtja e shpeshtë dhe periodike e të gjitha makinave ndërtimore nga një personel i specializuar
- Ndalimi i parkimit të përhershëm të automjeteve të vendeve të punës jashtë vendeve të punës.
- Përdorni, në masën e mundur, të materialeve inerte të prodhuara nga gjermimet, për të shmangur transportimin e agregateve nga pikat e largëta.
- Përgatitja e planifikimit të projektit në mënyrë që materialet e tokës nga gjermimet të merren brenda periudhës më të shkurtër të mundshme në pozicionet e argjinaturave.
- Ujë për lagështimin e grumbujve të agregateve
- Ujë i ricikluar për larjen e automjeteve të rënda për transportin, i cili do të vijë nga rezervuari i mbetjeve të ngjashme.
- Ndalimi i zjarreve në sipërfaqe të hapura.
- Sperkatja e hapësirës punuse me uje.

Masat shitesë zbutëse që do të zbatohen gjatë fazës së operimit - Një monitorim i cilësisë së ajrit, sipas legjislacionit kosovar dhe/ose praktikës së mirë ndërkombëtare do të zbatohet gjatë fazës së operimit.

Çdo burim i imitimit të ndotësve në atmosferë gjatë seperimit duhet të i plotësoj kushtet në vijim:

- që emisioni i materieve ndotëse të kufizohen dhe zvogëlohen në sasinë më të vogël të mundshme.
- që vlerat kufitare të emetimeve të mos kalohen
- që emisioni nuk duhet të ndikoj në kualitetin e ajrit mbi normat e caktuara.
- Minimi të mos bëhet në periudhë me erëra të forta. Në rast se e domosdoshme të paralajmërohen stafi, dhe të tjerë relevant që mund të preken nga pluhuri i krijuar gjatë minimimit.
- Gjatë seperimit, vazhdimin të kontrollohet procesi dhe të bëhet spërkatja adekuate;
- Të bëhet kontrolli i rregullt teknik i automjeteve transportuese

- Vazhdimisht të spërkaten me ujë platoja operationale, aty ku ka potencial për pluhur, sidomos gjatë kohës me erëra dhe me temperatura të larta.

Në kushtet e udhëheqjes së procesit teknologjik sipas normave të projektuara dhe me kontroll të mirëfilltë të pajisjeve për filtrim nuk ekziston rreziku që ndotja e ajrit të jetë mbi vlerat maksimale të lejuara të materieve ndotëse të caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes dhe normave të caktuara nga legjislacioni vendor dhe i BE. Kompania duhet të bëjë vendosjen e pajimeve për matjen e pluhurit dhe gazrave që lirohen gjatë punës dhe matjen e cilësisë të ajrit, vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes dhe normave të caktuara nga legjislacioni vendor dhe i BE. Vlerat e fituara ne bazë të matjeve duhet të dorëzohen ne MMPHI, intervali i matjeve do të kryhet ne bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe ne bazë të marrëveshjes me MMPHI.

11.2. Masat për mbrojtjen e ujit

Edhe pse ne procesin për seperim nuk lirohen ujera të ndotura teknologjike, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar mësipërme, ne hapësirat punuese, prandaj duhet ndërtuar kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet punuese, ujerat e grumbulluar nga sipërfaqet e lart cekura duhet të dërgohen për trajtim në separatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta dhe me vajra e yndyra të ndryshme.

Separatori duhet ndërtuar sipas standardeve dhe ne bazë të përmasave dhe përshkrimit të dhenura ne projektin kryesor të ndërtimit për ndërtimin e separatorit të vajrave. Separatori duhet në mënyrë të sigurt dhe kualitative të bëjë ndarjen (seperimin) e yndyrave dhe vajrave nga ujërat e ndotura, duhet ndërtuar me kapacitet të trajtimit të ujërave prej afër 80l/s. Separatori i vajrave për mes mureve ne disnivele e bënë ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pesetën e posaçme, ku pas mbushjes së pesetës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e separatorve dhe gropave septike. Separatori duhet të përmbush kriteret teknike që janë te parapara me rregullore dhe normative ne fuqi. Separatori duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht ne mënyrë vizuale uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.

Ujërat nga separatori dhe grupa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.

Shema teknologjike e trajtimit të ujrave




Figura 20. Shema teknologjike e ujrave.

Ujërat nga separatorët dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik.

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në ujëra, duhet ndër marrë këto masa shpesh:

- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operationale, dhe të hapet kanali rreth minierës, me qëllim të mbledhjes së ujërave të ndotura atmosferike, të grumbullohen dhe të drejtohen në pajimet për trajtimin e ujërave.
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferik nga sipërfaqet operationale (pusët sedimentuese)
- Duhet të merren masa paraprake, për mbrojtjen e rrjedhës ujore në afërsi, në mënyrë që të mos ndodhin ndërhyrje fizike, ndërprerje të rrjedhës ujore, apo ndotje e ujit. Ndër masat është ndërtimi i pengesave fizike, për të ndaluar kalimin e makinerive afër rrjedhës ujore.
- Të mos depositohen materie të lëngëta, ngurta, vajra, kimikate, përfshirë mbeturinat, në afërsi të rrjedhës ujore.
- Të gjitha pajimet, makineritë të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht;
- Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në vende të posaçme, të betonuara dhe të izoluara, përkatësisht nëpër punëtorë adekuate, kur nuk është e mundur, në rastet e makinerive të mëdha, si eskavator etj, ndërrimi i vajrave dhe shtimi i karburanteve të bëhet vetëm nga personat zyrtar dhe të trajnuar.
- Mbeturinat e ngurta duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten duhet të dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave - Mbeturinat komunale duhet të vendosen në kontejner adekuat të mbuluar me kapak, dhe duhet të bëhet marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave.
- Vajrat e përdorura duhet të vendosen në enë të vecant dhe t'u shiten kompanive të licencuara për mbledhjen e vajrave të përdorura;

- Të bëhet kontrolli i rregullt i makinerive ngarkuese dhe transportuese, për të parandaluar rrjedhjen eventuale të vajrave dhe karburanteve në tokë.

11.3. Masat për mbrojtjen e tokës

Faza e Para-Ndërtimit do të përfshijë aktivitete në lidhje me projektimin dhe zhvillimin e planeve përkatëse nga kontraktuesi përpara fillimit të ndërtimit. Masat për të parandaluar ndotjen e tokës, sipërfaqes dhe ujërave nëntokësore, si dhe erozionit, do të jenë pjesë e planeve të mëposhtme që do të zhvillohen nga kontraktuesi:

- Plani i Sedimentimit dhe Kontrollit të Erozionit;
- Menaxhim i sigurt i materialeve të rrezikshme dhe programit të parandalimit të derdhjes, dhe
- Plani i Menaxhimit të Mbeturinave.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së ndërtimit duhet të merren këto masa:

- Dheu i gropuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet në deponin regjionale, të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen në deponin regjionale.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.
- Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për ndërtimin e kompleksit të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit duhet të merren këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative të tëra hapësirat punuese në të cilat bëhet manipulimi me karburante duhet të mbulohen me beton.
- Duhet të vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, dhe enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lënget.
- Duhet të pajiset me sistemin sekondar për mbledhjen e derdhjeve aksidentale.
- Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

- Duhet i tërë oborri i hapësirës punuse të thuret me tel gjembor.
- Të gjitha pajimet, makineritë të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht.
- Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në vende të posaçme, të betonuara dhe të izoluara, përkatësisht nëpër punëtorë adekuate, kur nuk është e mundur, në rastet e makinerive të mëdha, si ekskavator etj, ndërrimi i vajrave dhe shtimi i karburanteve të bëhet vetëm nga personat zyrtarë dhe të trajnuar.
- Mbeturinat e ngurta duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten duhet të dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave
- Mbeturinat komunale duhet të vendosen në kontejner adekuate të mbuluar me kapak, dhe duhet të bëhet marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave.
- Vajrat e përdorura duhet të vendosen në enë të veçantë dhe t'u shiten kompanive të licencuara për mbledhjen e vajrave të përdorura.
- Të bëhet kontrolli i rregullt i makinerive ngarkuese dhe transportuese, për të parandaluar rrjedhjen eventuale të vajrave dhe karburanteve në tokë.

11.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Duke pasur parasysh lokacionin ku do të ndërtohet në një zonë ku objektet e banimit janë me një distancë mbi 2km, zhurma e krijuar gjatë punës dhe auto mekanizmit nuk do të ketë ndikim të theksuar në mjedis.

Masat kryesore zbutëse për të zvogëluar zhurmën, si dhe nivelet e dridhjeve gjatë ndërtimit janë këto:

- Të gjitha automjetet dhe makineritë e përdorura në vendet e ndërtimit do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt. Automjetet dhe makinat që janë tepër të zhurmshme për shkak të rregullimit të dobët të motorit ose pajisjeve të kontrollit të zhurmës nuk duhet të funksionojnë derisa të jenë zbatuar masat korrigjuese.
- Kur është e mundur, të gjitha pajisjet e ndërtimit do të jenë në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE 2000/14 / EC për emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim jashtë (ekziston mungesa e legjislacionit kombëtar për nivelet e zhurmës së emetimit të pajisjeve në natyrë). Të gjitha pajisjet duhet të kenë shënimin CE dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së shëndoshë dhe shoqërohen me një deklaratë të konformitetit të KE.
- Pajisjet do të pajisen me pajisje të përshtatshme për zhurmë zhurmës që do të zvogëlojnë nivelet e zërit.
- Çdo përpjekje do të bëhet për të përmbushur kufijtë e zhurmës së korrespondentit për secilën zonë ku do të zhvillohen punimet e ndërtimit.
- Punimet e ndërtimit nuk do të lejohen gjatë natës; operacionet në vend do të kufizohen në orët 07.00 - 19.00 h;
- Banorët e prekur lokalë do të informohen, në maksimum, për përpjekjet e projektit, në kohën e duhur të punimeve të planifikuara, nivelet e dridhjeve dhe zhurmës dhe orët e ditës gjatë së cilës ato do të ndodhin.
- Në rastin kur punimet e zhurmshme duhet të kryhen natën ose gjatë një periudhe më të gjatë se një ditë në një vend të caktuar, do të ngrihet një pengesë e zhurmës rreth zonës së punës.

- Aktivitete të tilla si prishja, funksionimi i tokës dhe ndikimi në tokë do të planifikohen në mënyrë që të mos ndodhin në të njëjtën kohë. Për dallim nga zhurma, niveli i përgjithshëm i dridhjeve të prodhuara mund të jetë dukshëm më i vogël kur secili burim dridhjeje vepron veçmas;

Ne fazën e funksionimit - Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të prodhimit duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

11.5. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar kemi një degradim të vegjetacionit nga kompanit të ndryshme që veprojnë në këto zone, të cilat kanë karakter minerar. Vegjetacioni në tërësi do të humbë kur të ndërtohet impianti, nga sipërfaqet nën objektet përcjellëse dhe nën platonë e seperacionit.

Sipërfaqet e liria të ngastrës për rreth do të mbillen me bimë dhe drunje dekorativ. E njëjta do të vlerëtohet edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompanisë ju është bërë e qartë që gjatë procesit të funksionimit që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në rast të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merren masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit etj.

11.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku do të ndërtohet ky seperacion nuk kemi ndonjë shtepi në afërsi që do të rrezikohet nga jeta e njeriut dhe për këtë arsye nuk do të ndikoj në vendbanim apo popullatë përkundrazi do të ndikoj pozitivisht. Më mirë po duhet të ndermarren të gjitha masat e nevojshme gjatë procesit të ndërtimit dhe operimit.

11.7. Rastet aksidentale

Kompania duhet të bëhet planin e intervenimit për rastet aksidentale. Duhet të merren një seri masash:

- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet i tërë oborri i seperacionit të thuret me tel gjembor.
- Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese si dhe pajimet prodhuese.

- Kompania duhet të jetë e pajisur me pajime kundërzjarri, të ketë mundësi alternative të portave hyrje dalje.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.
- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

11.8. Siguria përfshijnë punët përgatitore

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të, si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventivat) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim (renovim) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve.

Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes. Punishtja duhet të rrethohet nga teli i metalit me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe ndërprerjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rilidhjen e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin e instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EN, EC dhe ISO.

Këto punë nënkuptojnë dhe përfshijnë punët përgatitore të rrethinës para nisjes së projektit kryesor të arkitekturës dhe enterierit. Punët përgatitore janë të përshkruara në vijim:

- Shenjëzimi i saktë i zonës nën NDËRTIM dhe kantierit/punishtes ndaj zonave tjera në afërsi
- Shkëqja e përkohshme e instalimeve ekzistuese (nëse ka të tilla), kycja e instalimeve të përkohshme për punishte, kycja e rrymës pas përfundimit të punimeve si dhe ruajtja e instalimeve ekzistuese të cilat do të mbesin në shërbim (funksion) edhe pas ndërtimit të objektit
- Rrethimi i punishtes me gardh jo transparent, të përkohshëm me lartësi $h=1.8$ m Instalimi i zyrës/kontenierit të përkohshëm në punishte (~12m²).

Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial te vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave te forta te cilat mund e bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës, si dhe nga ndikimi nga djegia e derivateve ne makineria punuese dhe ato lëvizëse, lënda djegëse dhe pluhrit qe lirohet gjate procesit teknologjik etj.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve te parcelës, Mirëmbajtja e makinerisë punese, Mirëmbajtja e makinerisë lëvizëse dhe mos ndezja e motorëve te tyre pa nevojë, Përdorja e lendes ngrohës miqësore me ambientin etj. Përdorimi i sistemit te ujit gjate procesit teknologjik dhe me gjere.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston te dheu dhe ujërat nëntokësore	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit të ujërave te shkarkuara nga procesi i pastrimit te paisjeve dhe ujrut siperfaqesore.	Kompania planifikon te ndërton impianti për trajtimin ujerave të ndotura te shkarkuara nga hallkat e ndryshme.
Natyrë dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Potencial minimal, nuk ka zona te rrezikuar ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku do te ndërtohet Impianti është sipërfaqe e vogël, dhe kjo nuk mund të ndikoj në shkallen e mikrosistemit.	Me që në vendin i Impiantit eshte po thuajse se zone industriale, dhe nuk ka florë dhe faune shume te zhvilluar në përgjithësi, rriten dhe zhvillohen llojet e ndryshme të florës dhe faunës. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
Zhurma	Potencial minimal	Nga ky aktivitet për Impiantin ka potenciale te vogla te shkaktohet zhurmës	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim te madh në ambientin jashtëm.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës se Impianti për rreth tij	Te gjitha pajisjet te cilat mund te kenë ndikime ne shëndetin e qytetareve do tu kushtohet rëndësi e veçan ne mirëmbajtjen e tyre.

11.9. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit te Impiantit krijohen mbeturinat komunale ditore nga puntort. Ndersa gjate procesit teknologjik te prodhimit nuk gjenerohen mbeturina.

Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikat e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Largimi i mbeturinave do te behet nga kompanit komunale qe sherbejn per grumbullimin e mbeturinave qe gjenerohen nga puntort.

Për mbetje e mundshme te këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

- Mbeturinat e riciklueshme do te grumbullohen dhe do te dërgohen për riciklim,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do te trajtohen komfor legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

12. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me Impiantin për seperimin nga kompania "RUBINI CORP" SH.P.K, duke e analizuar procesin teknologjike mendoje që nuk do të kemi, rrezik mund të kemi nga energjia elektrike dhe avarit e ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania do të marrë të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

13. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi - Pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore, monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komfort ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent .

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhimet, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore e cila lëshohet nga MMPHI.

14. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Problematika e shfrytëzimit të tokës bujqësore për nevoja jobujqësore është rregulluar me Ligj dhe akte nënligjore. Sipas Ligjit për tokën Bujqësore (Ligji nr. 02/L-26) për Rikultivim të tokës bujqësore, me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës për nevoja të eksploatimit të mineraleve. Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore, depozitë e mbeturinave, hirit industrial dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Toka bujqësore pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Rikultivimi i tokës bujqësore. Toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera, e cila nuk ka karakter të përhershëm, i kthehet destinimit të parë apo destinimit tjetër, përkatësisht aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projektit për rikultivim. Pëlqimin në projektin për rikultivim e jep organi kompetent komunal për bujqësi.

14.1. Objektivat e rikultivimit

Pas përfundimit të aktivitetit (kjo varet nga kërkesa e tregut dhe gjendja teknike e pajimeve). Pas këtij afati pajimet duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi përkatëse.

Nga proceset teknologjike të prodhimit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përbërës granulat, që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi i tij me at të rrethit ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin, me reparacion të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues.

14.2. Qëllimi i Rikultivimit

Qëllimi kryesor i rregullimit të hapësirës pas pushimit të aktivitetit, është kthimi i kësaj zonë të degraduar në një zonë me një peizazh shumë rekreativ për komunitetin për rreth.

Në përgjithësi, zona do të paraqesë element me vlerë të lartë për mjedisin, në të cilin do të ekzistojnë në të njëjtën kohë shfrytëzimi bujqësor dhe vendbanimi për botën bimore dhe shtazore. Krijimi i tokave antropogjene në këtë zonë nënkupton ripërtëritjen e tokës së dëmtuar, harmonizimin e peizazhit, si dhe zgjerimin e kapacitetit të filtrit natyrorë të ajrit. Për rikultivim do të jetë e nevojshme shtresa pjellore e tokës dhe shtresa potenciale pjellore me përmbajtje agrokimike dhe mekanike. Sipas rregullave krijimi i biomasës me anë të rikultivimit në toka të degraduara ka për qëllim gjelbërimin dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit të jashtëm konformë peizazhit rrethues.

- *Struktura përfundimtare e sipërfaqeve*

Pas përfundimit të punimeve me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera. Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku do të vendoset impianti të behet me mbjelljen e fidanëve të ngjashme me pyjet rrethuese, nëse nuk adaptohet për ndonjë aktivitet tjetër blegtorie psh. ngritje të ndonjë ferme ekologjike, ose edhe si toke pune apo kullosa, etje si alternativa të mundshme.

- *Rikultivimi agroteknik dhe biologjik*

Njëra prej detyrave me të rëndësishme në ngritjen e plantacioneve është zgjedhja e materialit fidanor dhe teknika e mbjelljes së fidanëve. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e fidanëve fryt dhënëse është vjeshta, pasi që rrënja është aktive gjatë dimrit si dhe ekziston sasi optimale e lagështisë, kështu që bima në stinën e pranverës ka start me të suksesshëm. Para mbjelljes është mirë që toka të punohet në thellësi deri në 70 cm.

Për mbjellje duhet të hapën gropat të cilat duhet të jenë aq të mëdha sa sistemi rrënjor i fidanit të vendoset lirshëm në gropë ose shprehur në dimensione 60 x 60 cm gjerësi dhe deri 40 cm thellësi. Nëse nuk behët qeliza e tokës atëherë gropa duhet të hapet duke e ndarë dheun e shtresës së sipërme në njërën anë dhe pjesën tjetër në anën tjetër. Përgatitja e tokës është mirë të bëhet se paku një muaj ditë para mbjelljes.

- *Përgatitja e fidanit*

Përgatitja behët në atë mënyrë që 1/3 e rrënjëve prehen me gërshërë të mprehta në mënyrë që të inicohet rritja e rrënjëve. Prerja duhet të shkaktoj plagë sa më të vogla.

Fidanët e përgatitura i fusim në një enë në të cilën është hedhur 50% bajaga, 50% argjilë (dhe i imtë) dhe një sasi uji.

Të gjitha këto përzihen deri sa të formohet masa e qulltë. Në këtë masë zhytet sistemi rrënjor i fidanit e pastaj fidanët shpërndahen nëpër gropa për mbjellje.

- **Mbjellja**

Mbjelljen e fidanit e bëjnë zakonisht dy punëtor. Njëri e mban fidanin, ndërsa tjetri e mbulon sistemin rrënjor të futur në gropë në atë mënyrë që sistemi rrënjor të shpërndahet njëllë në të gjitha drejtimet. Në fund të gropës mund të vendoset edhe shkopinjtë e drurit në mënyrë që fidani të përforcohet. Në fund të gropës hidhet 150 gr. Pleh mineral NPK që shërben si ushqim e pastaj hidhet një sasi e dheut të imët në formë koni e pastaj vendoset sistemi rrënjor i fidanit.

Mbi rrënjë vendoset shtresa tjetër e dheut e cila me këmbë ngjeshët mirë e mirë. Mbi këtë shtresë vendosen 10-15 kg pleh organik, por duke mos pasur kontakt direkt me rrënjët. Mbi pleh vendoset prapë shtresë e dheut e cila ngjeshët mirë e mirë duke mos lënë ajër në mes rrënjëve dhe dheut.

Fidanët duhet të mbillen në atë thellësi në të cilën ka qenë në fidanishte. Fidanët përforcohen për hua duke i lidhur me shpagë në formë të numrit tetë dhe në të është e vendosur etiketa e llojit të fidanit. Rreth fidanit hidhet shtresa e mbetur e dheut duke i dhënë formën.

Nëse fidani është mbjellë në vjeshtë i jepet forma e humkës që të largohet uji i tepërt ose në formë të çinisë që të mbledh ujin gjatë verës.

Distanca e mbjelljes së fidanëve, Në skicë është paraqitur distanca e mbjelljeve që është 4 m rendi prej rendit, dhe 4 m bima prej bimës, drejtimi i mbjelljes është veri – jug, si ne fig ne vijim.




Figura 21. Shema e distancës së mbjelljes

Për të llogaritur numrin e fidanëve që do të mbillen përdoret formula

$$Nrf = \frac{S}{a \times b} = \frac{10.000}{4 \times 4} = 625 \text{ fidane/ ha}$$

Nrf – numëri i fidanëve, S-sipërfaqja, a-distanca e fidanëve në rend, b-distanca në mes

rendeve të shprehur në m.

Numri total i fidanëve të nevojshme për rikultivim në sipërfaqen 2 ha është 1250

Llojet e bimëve që do të mbjellën për krijimin e ekosistemit të ri

Fidanët frytdhëse, si që janë: mollat e varieteteve të ndryshme, dardhat e varieteteve të ndryshme, kumbullat e varieteteve të ndryshme, qershit e varieteteve të ndryshme, nektarinat e varieteteve të ndryshme mollët e varieteteve të ndryshme, etj.

Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçanti sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së fidanëve, pronari më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre.

a. Rrethimi i plantacionit

Sipërfaqja e rikultivuar për tu mbrojtur nga dëmtimet fizike duhet rrethuar menjëherë si të filloi mbjellja e bimëve. Për ta rrethuar këtë sipërfaqe më parë duhet të vendosen shtyllat e çimentos ose drurit në distanca 3-4m, e pastaj në këto shtylla vendoset rrjeta e telit.

15. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinionëve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të arrijmë në një përfundim si në vijim:

Implantit për seperim nga kompania "RUBINI CORP" SH.P.K. do të ushtroj veprimtarinë e sajë në Rahovec, në zonën kadastrale të Rahovecit, në ngastrat kadastrale NR: P-71510057-02256-0 e që është në interes të;

- të vet investitorit për të përmirësuar kushtet e punës, dhe rritjen e kapacitetit të zhavorit;
- në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me të menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.

Në rast se implanti për seperim nga kompania "RUBINI CORP" SH.P.K. mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, ky aktivitet minierar do të konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik. Duke u bazuar në natyrën e implanti dhe aktivitetit të sajë, vendndodhjen e së Implantit, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal do të jenë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit.

16. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori
- Propozim-PZHK-2021-2027_per-Shqyrtim-Publik.pdf (rks-gov.net)
- Kërko dhe paraqit - KGP (rks-gov.net)
- OpenStreetMap
- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (rks-gov.net)
- Therandë për në Balkans - Google Maps
- Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Rahovecit
- Qavolli. R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës. Prishtinë.
- MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
- B. Shehu dhe K. Karaxha, Hidrologji Inxhinjerike, 1996, Tirane,
- K. Katundi, Furnizim me ujë dhe trajtimi i tyre, Tiranë,
- MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
- MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
- MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
- MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
- MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosovës 2015,
- MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014,
- Te dhënat nga investitori Ndërmarrja banesore Sh.A. Prishtine